

Rruga, ëndrra që mbeti ëndërr

Nga Dhimitër GEGPRIFTI

Mokra Sipër dhe banorët e saj prej dekadash kanë patur dhe kanë një ëndërr. Kanë dashur dhe vazhdojnë të duan një rrugë. Rrugë me të gjithë parametrat e saj të nevojshëm si në të gjithë Shqipërinë. Por ajo, asgjë më shumë, ka mbetur dhe vazhdon të mbetet një ëndërr e mirë, se një ditë do ta kenë atë. Po. Kur?

Krahina për të cilën po flasim përbëhet nga 14 fshatra, por aktualisht banorët janë zhvendosur drejt qytetit të Pogradecit, por edhe në të tjerë. Kjo lëvizje demografike ka bërë të mundur të largohen, gati gjysma e popullsisë. Mbi 8.000 e ca banorë, sot janë rreth 4,500! Shkaku: për kushtet më të mira, që krijoi Demokracia. Shkak tjetër, pothuajse determinativ Rruga.

Në këtë shkrim kemi përfshirë vetëm këtë zonë, pasi Mokra Poshtë, në këto dy dekada të Demokracisë ka tregues zhvillimi në shumë drejtime, krahasuar me atë Sipër dhe kjo për meritë të Push-

INTRVISTË ME KRYETARIN E KOMUNËS PROPTISHT, Z.FUAT FERRO

“Jam dhe do të mbetem deri në fund shërbetori i komunitetit”



Gazeta “Mokra”: - Mirë se u takuam zoti Fuat! Meqënëse më dhe lajme interesante, dëshironi të botojmë diçka në gazetën “Mokra”? Si intervistë apo si bashkëbisedim mjafton të lemë gjurmë për historikun e komunës Proptisht, në prag të 100-vjetorit të Pavarësisë.

Fuat Ferro: - Faleminderit për vlerësimin e informacionit dhe pranoj që të botohen në gazetën “Mokra”, në formën e intervistës. Si fillim, më lejoni të bëj komentin tim të shkurtër për këtë gazetë, e cila është bërë pjesëtare e shumë familjeve mokrare, ku gjithësecili gjen veten e tij në problematikat që kjo gazetë shkruan. Ju falenderoj për këtë!



INTERVISTË E DR. PASKO VAKO DHËNË GAZETARIT LLAZITONA

Situata demografike në Shqipëri, dukuri të mira dhe jo të mira”

NË 100 - VJETORIN E PAVARËSISË!

“Kushedi sa gjak do të derdhet për të lëvizur këta gurë”

(Coptimi i Shqipërisë në vitin tragjik 1913)

DHIMITËR BURNAZI (XHA MITI), NJERIU, QË BËNTE GURIN “TË FLASË”

Xhaferi i Files

Nga Istref HAXHILLARI

LIBRAZHD: SHUHET KOREOGRAFI SADI HALILI, NJERIU QË VALLËZONTE PA KËMBË



REGJIMENTI I POGRADECIT ISHTE I PARI QË SHKOI TË MBROJË KUFIRIN, NGA PROVOKACIONET E USHTRISË GREKE, NË GUSHT 1949

Nga Zenun FERRO

“FLLAMBRA”, FLAMURI I AROMANËVE
Të ruajmë e transmetojmë vlerat e virtytet e popullit tonë

Nga Koço PIHONI

LAJMERIM

Lajmërohen të gjithë anëtarët e shoqatës “Pelioni”, miqtë dhe dashamirët e kësaj shoqate dhe të gazetës “Mokra” se më 23 nëntor, ora 12.00 do të bëhet një takim i zgjeruar, me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë, në ambientet e restorantit te pisha në kala, në Pogradec.

Rruga, ëndrra që mbeti ëndërr



Nga Dhimitër Gegprifti

Mokra Sipër dhe banorët e saj prej dekadash kanë patur dhe kanë një ëndërr. Kanë dashur dhe vazhdojnë të duan një rrugë. Rrugë me të gjithë parametrat e saj të nevojshëm si në të gjithë Shqipërinë. Por ajo, asgjë më shumë, ka mbetur dhe vazhdon të mbetet një ëndërr e mirë, se një ditë do ta kenë atë. Po. Kur?


Krahina për të cilën po flasim përbëhet nga 14 fshatra, por aktualisht banorët janë zhvendosur drejt qytetit të Pogradecit, por edhe në të tjerë. Kjo lëvizje demografike ka bërë të mundur të largohen, gati gjysma e popullsisë. Mbi 8.000 e ca banorë, sot janë rreth 4.500! Shkaku: për kushtet më të mira, që krijoi Demokracia. Shkak tjetër, pothuajse determinativ Rruga.

Në këtë shkrim kemi përfshirë vetëm këtë zonë, pasi Mokra Poshtë, në këto dy dekada të Demokracisë ka tregues zhvillimi në shumë drejtime, krahasuar me atë Sipër dhe kjo për meritë të Pushteteve Vendore të tyre Proptisht e Velçan, por edhe të faktorëve të tjerë socialë. Në periudhën 1992-2012 në komunën Trebinjë nuk është ndërtuar asnjë vepër publike, që të mbajë "firmën" e një titullari, në asnjë sektor jetik.

Nëse dikush nuk e beson, realiteti flet vet, flet rruga. Ajo, që mund të lidhë dy Mokrat: ura e Slabinjës-Varrezat e Grekut- Pogradec, por edhe qendra e Komunës Trebinjë-Varrezat e Grekut- Pogradec. Gjatë këtyre 20 viteve edhe në këtë komunë janë bërë „investime“ dhe qindra miliona, po ku kanë shkuar? Në rrugë dytësore pse jo dhe „tretësore“, ku nuk duket asgjë, veç traseve, gurëve dhe baltës. Më ndonjë aks janë hedhur para dy e tre herë?!...

Nënteksti i këtij shkrimi

Duke iu drejtuar Juve, i nderuar staf i asaj redaksie, jemi të bindur se sjellim shqetësimin e një komuniteti të kësaj zone dhe më gjerë dhe me shqetësimin tonë do të bashkohen edhe Ju. Ne nuk u drejtohemi atyre redaksive, që bëjnë edhe „opozitën“ dhe lexuesi mendon padrejtësisht, sikur ne duam të atakojmë mazhorancën në pushtet. Jo! Ne mendojmë se shkrimi ynë më shumë se kaq është një apel drejtuar Qeverisë Qendrore, tek e cila shikojmë zgjidhjen e vetme e të mundshme, që ka populli i zonës së Mokrës Sipër. Kjo zgjidhje mbështetet në faktin se në të gjithë Shqipërinë çdo ditë inagurohen rrugë. Edhe ditët e fundit zoti Berisha deklaroi publikisht për të disatën herë se Qeveria është e vendosur të ndërtojë infrastrukturë, rrugë në të gjitha zonat rurale, për përmirësimin e kushteve të jetesës, për një frymëmarrje më të gjerë, për ta afruar sa më shumë me tregun dhe qytetin. Rruga për të cilën flasim është ajo, që lidh qytetin e Pogradecit me qendrën e komunës Trebinjë. Ne



mendojmë se është një garanci më shumë dhe besim se në vitet 1993-1994 në këtë rrugë ka shkuar drejt kësaj komune Kryeministri, zoti Sali Berisha. Në këto kushte na lejohet të supozojmë se, nëse Qeverisë do t'i ishte parqitur projekti i saj nga titullarët e kësaj komune, besojmë se ajo sot do të ishte e ndërtuar. Pra, nuk është „faji“ i Qeverisjes Qendrore, por mosinteresi i atyre, që marrin mandatin për të qeverisur nga ky komunitet dhe harrojnë përse janë ulur në atë karrike. Në këtë rrugë kanë udhëtuar dhe vazhdojnë të udhëtojnë deputet „të majtë“ e „të djathtë“, para dhe pas fushatave elektorale, por edhe puna e tyre lë shumë për të dëshiruar?!

Retrospektivë: drejt qendrës së kësaj komune

Motivi i këtij shkrimi „më detyron“ të kthehem në kohë, në vitin 2003, kur për probleme të mprehta sociale të kësaj zone kam botuar shkrimin: „Në Pleshisht dhe Mokër pas 60 viteve“ (është fjala për festën e përvitshme të Mokrës), botuar në gazetën lokale „Nositi“. „...gjatë rrugës për në festë hasim makina të mirmbajtjes. Dhe ato kanë detyrim për këtë festë: mbushin gropat, se do të vijmë Qeveritarët!?!... Të tjerë thonë Presidenti. Dikush do të vij...Nuk piptin e nuk lëviz njeri, pa le makinë, që njerëzit e kanë harruar. Shumë të larguar...Vite me radhë këta njerëz kërkuan rrugë, ujë, mjek, ambulancë, por pak, shumë pak dhe kështu i

drejtohen qytetit diku.“ Nuk erdhi asnjë! Asnjë telegram nga askush! Kështu vlerësohet Mokra? ...Nga ura e Slabinjës e deri në Varrezat e Grekut traseja e rrugës ekzistuese është ndërtuar gjatë luftës italo-greke, që njihet me emrin rruga „Marinuçi“. Ushtria italiane atëherë edhe luftonte dhe ndërtonte rrugë. Edhe sot të kënaqet syri, kur shikon atë punë aq të kujdesshme e me cilësi, vetëm me gurë, reziston edhe sot, pas më shumë se 70 viteve, por ende e paasfaltuar!?

Është e pabesueshme dhe qesharake të thuash se sot në këtë trevë nuk ka asnjë metër rrugë asfalt?! Rreth 350-400 ml u „asfaltuan“ në Podkozhan dhe Pleshisht se do bëhej përvjetor dhe festë dhe ato sot janë shkatërruar dhe i mbulon balta dhe gurët...

Thonë se...

Ide dhe projekte për këtë rrugë ka patur që herët. Kanë patur italianët, diskutimet ka patur dhe ka ende tani për projekte me variante të ndryshme. Është diskutuar për një tunel të mundshëm, u hap një trase e re nga Kalaja duke shkurtuar gati 50% të asaj ekzistuese, u çel trase e re, ajo, që është sot nga Varrezat e Grekut në drejtim të Vërdovës-Pogradec. Por të gjitha kanë mbetur diskutime, ëndrra.

Nëse doni të besoni, në këto, që po shkruajmë, le të vijë njëri nga Ju zotërij qeveritarë, që „kini në dorë“ këtë ëndërr ta bëni realitet: deputet apo Ministër dhe të udhëtoni në këtë rrugë. Jo me makinat tuaja, por me ato, që udhëtojmë ne dhe të dëgjonit me veshët tuaj

shqetësimet e këtyre njerëzve për këtë rrugë: „S'u bë e s'u bë kjo rrugë!, Vetëm kjo të ishte bërë dhe do të ishin bërë të gjitha. Të gjithë premtojnë dhe të gjithë nuk bëjnë asgjë., Paratë e rrugës i kanë kryetarët., Si nuk doli një burrë për këtë Mokër. E kështu me radhë, mund të radhitim plot. Të njëjtin shqetësim. Rruga dhe njëfarë shprese, disi e humbur

Fakt shpresëdhënës...

Ka kohë, që ka filluar zbatimi i projektit të rrugës Qukës- Qafë-Plloçë. Shumë njerëz diskutojnë se ky projekt nuk do t'i zgjidh problemet e kësaj zone, pasi, sipas të thënave, projekti është largë zonave urbane. Por edhe kjo arritje për këtë zonë është e pabesueshme, do të na duket si një ëndërr realiste. Atë, që s'e bënë, gati shtatë dekada, do të bëhet për disa vite. Nga Mokrarë e qytetarë qarkullojnë mendime lidhur me autostradën Qukës- Qafë-Plloçë: „Ajo le të ndërtohet, pasi ka synime eperspektiva më të gjera në të ardhmen, por të ndërtohet si të jetë e mundur edhe rruga e Mokrës. Projekti i nisur mund të ishte edhe më pak i kushtueshëm, nëse ndërtohej aksi Qafë-Thanë-Qafë-Plloçë dhe të vazhdonte në rrugën e vjetër, pasi traseja është e çelur dhe e sigurt. Mokrarët duhet të shkojnë në Plloçë e mandej të kthehen në Mokër. Rruga Vërdovë-Komuna Trebinjë nuk është më shumë se 23-24 km, me shumë pak investime dhe për një kohë të shkurtër përfundon. Austradën e bën shumë të kushtueshme fakti, thonë, ata që njohin projektin dhe zonën, se mungesa e çakllit në të gjithë këtë zonë, ku kalon projekti është shkaku kryesor për koston 500-700 milionëshe euro. Variantet e menduara mund të ulin koston me 300-400 milion euro...“

Ja një Projektide e rrugës për në Mokër për mandatin 2005-2009

Në çdo fushatë elektorale mokrarëve Mokra u del me një imazh tjetër: me rrugë, me drita, me ujë, me investime në sektorë të ndryshëm, por pak ose aspak bëhen nga ato.

Megjithatë mokrarët jetojnë, punojnë. Ata janë të punës, të sakrificës dhe të mikpritjes. Ata janë pa shumë pretendime. Ata u kërkojnë Pushtetarëve Rrugën, Ujin, Shërbimet sociale, se të tjerat i bëjnë vet. Mokra mbetet Mokër dhe Mokrari, Mokrari. Kjo është mokra me historinë dhe lashtësinë e saj. Kjo është Mokra Sipër 2012, por me besim në vitet, që vijmë, do ta gjejmë ndryshe. Ajo nuk do vetëm vlerësim, por edhe investim. Për këtë besojmë!

Struga e Pogradeci pretendon UNESCO-n

Duke pasur parasysh se pjesa e Liqenit të Ohrit dhe vetë qyteti i Ohrit, janë të mbrojtur nga UNESCO si trashëgimi natyrore dhe kulturore, ndërsa Struga nuk është, edhe pse ndodhet vetëm 15 km nga Ohri dhe laget nga ujërat e Liqenit të Ohrit, i mbrojtur nga UNESCO. Po ashtu edhe qyteti i Pogradecit dhe pjesa e Liqenit të Ohrit që gjeografikisht shtrihet në Shqipëri, nuk janë pjesë e përkujdesjes dhe mbrojtjes nga UNESCO.

Gjatë nënshkrimit të Deklaratës së krijimit të rezervatit biosferik në rajonin Ohër-Pre-spë, në pyetjen drejtuar ministrave të mjedisit të Shqipërisë dhe Maqedonisë, Fatmir Mediu dhe Abdilaqim Ademi lidhur me këtë çështje, siç transmeton INA, ata u shprehën:

Fatmir Mediu: “Që të flasim drejtë, vetëm Ohri është pjesë e UNESCO-së, ndërsa Po-

gradeci dhe Struga janë pjesë e preokupimit tonë për tu futurë në UNESCO, me të njëjtin Program të UNESCO-së. Ne prandaj po shikojmë në mënyrë më të integruar duke përfshirë edhe zonën e mrekullueshme të Prespës e cila është shumë e lidhur me Ohrin, jo vetëm për shkak të shkarkimit të ujit por edhe mendoj se është edhe një raport i biodiversitetit dhe rezerva biosferike që duhet konsideruar në mënyrë të përbashkët. Me gjithë që qëllimi është që të fillojmë dhe sot në zonat biosferike të Ohrit dhe të Prespës, duke konsideruar të gjithë komunitetet, apo qytetet, apo komunat që janë rreth këtyre dy liqeve shumë të rëndësishme“. Ministri Abdilaqim Ademi ripërsëriti se: “Me Deklaratën e nënshkruar do të sigurohet mbështetja e nevojshme e subjekteve lokale dhe të të gjitha palëve të tan-guara në lidhje me njohjen jo vetëm të rezer-

vatit biosferik nga programi i UNESCO-s “Njeriu dhe Biosfera, por edhe përfshirja e komunës së Strugës si dhe të Pogradecit”.

“Vetë Liqeni i Ohrit, në anën e Maqedonisë, ka marrë një lëvdatë nga UNESCO si një lokalitet i Trashëgimisë Botërore Natyrore, gjë të cilën përpiqemi të bëhet edhe Struga nga ana e Maqedonisë, ndërsa në anën e Shqipërisë është përgatitur një dokumentacion i ngjashëm për marrjen e të njëjtës lëvdatë edhe për pjesën shqiptare dhe qytetit të Pogradecit, duke u shtrirë mandej edhe në zonën e Prespës. Pjesa e Maqedonisë në Pjesën e Madhe të Liqenit të Prespës dhe pjesën e Greqisë të Liqenit të Madh dhe të Vogël të Liqenit të Prespës, sipas Konventës së Ramsarit, janë të pranuarra për Kënetë me vlera ndërkombëtare ndaj edhe është një marrëveshje trepalëshe midis tri vendeve bregliqenase, Maqedoni-Shqipëri-Greqi”-përfundoi Ademi.

INTRVISTË ME KRYETARIN E KOMUNËS PROPTISHT, Z.FUAT FERO

"Jam dhe do të mbetem deri në fund shërbëtori i komunitetit"

Gazeta "Mokra": - Mirë se u takuam zoti Fuat! Meqënëse më dhe lajme interesante, dëshironi të botojmë diçka në gazetën "Mokra"? Si intervistë apo si bashkëbisedim mjafton të lemë gjurmë për historikun e komunës Proptisht, në prag të 100-vjetorit të Pavarësisë.

Fuat Fero: - Faleminderit për vlerësimin e informacionit dhe pranoj që të botohen në gazetën "Mokra", në formën e intervistës. Si fillim, më lejoni të bëj komentimin tim të shkurtër për këtë gazetë, e cila është bërë pjesëtare e shumë familjeve mokrare, ku gjithësecili gjen veten e tij në problematikat që kjo gazetë shkruan. Ju falenderoj për këtë!

Gazeta "Mokra": - Së pari, më befasoni me projektin që keni për monumentin e Selcës, 45 vite i harruar, sikur ajo pema e braktisur, pas vjeljes. Njëherësh është optimist fakti që projektin e hudhëheq profesor Neritan Ceka, që i vuri emrin Pelionit. Gjithësesi, ku konsoston projekti tuaj dhe sa u ofronë?

Fuat Fero: Monumenti i Selcës Poshtë, "Pelioni", është një deshmi e gjallë e lashtësisë, e historisë dhe autoktonisë të kombit shqiptar dhe detyra e çdo brezi është që ta ruajë e ta transmetojë tek çdo brez që vjen, pikërisht këto vlera pa i larguar aspak origjinalitetit. Duke bashkëpunuar me profesor Neritan Cekën, ku nëpërmjet kësaj interviste dua ta falënderoj për punën e palodhur që ka bërë e po bën aktualisht, bashkë me një grup arkeologësh shqiptarë e italianë, jemi në fazën përfundimtare të hartimit të projektit, i cili do t'u shkojë instancave më lart për financim. Ky projekt ka si qëllim që çdo ndërhyrje të ruajë origjinalitetin e vlerave monumentale.

Pjesë e këtij projekti është dhe shtrim-asfaltimi i rrugës Selcë-Varrezat Ilire-Kriçkovë, ndërtimi i ujësjellësit për fshatin Kriçkovë-Varrezat Ilire dhe Selcë si dhe ndërtimi i një shkolle fillore në Selcë, ku një pjesë e ambientit të saj të kthehet në muzeum për vizitorët e vendit dhe të huaj. Ne si komunë kemi ndërhyrë me fondet tona dhe kemi ndërtuar 2 mure mbajtës të rrugës që të çon në Selcë si dhe kemi rregulluar çesmën në qendër të fshatit dhe dy çesma të tjera në lagjet e këtij fshati. Vlen të theksojmë se çdo ditë kjo qendër vizitohet nga vizitorë të ndryshëm dhe kjo na bën që të realizojmë detyrimin tonë.

Gazeta "Mokra": Në këtë verë përvëluese Mokra mbeti e blertë, perjashtuar ndonjë vatër zjarri jetëshkurtër. Cila qe gadishmëria e komunës? Më shumë se kaq, a duhet të jemi mirënjohës banoreve mokrarë, të cilët prej natyrës nuk e kanë zakon të djegin për



"t'u ringjallur nga hiri i vet", sikur ndodhi në shumë krahina të tjera të vendit?

Fuat Fero: - Vërtet ndihem krenar dhe emocionohem kur shikoj hapësirën e blertë të territorit të komunës Proptisht të pacënuar nga zjarret. Kjo falë punës sensibilizuese dhe ndërgjegjësimit të banorëve të komunitetit. Nga ana e komunës është ndërtuar një sistem i tillë organizimi ku në marrjen e sinjalit nga ana e vëzhguesve në terren menjëherë vihen në lëvizje tërë administrata e komunës, kryesitë e fshatrave dhe duke aktivizuar gjithë banorët e fshatrave në shmangjen e zjarreve. Raste kemi pasur në fshatin Rrodokal Poshtë e Rrodokal Sipër, Kriçkovë, Slabinjë por janë eliminuar shumë shpejt, falë punës së shpejtë që është kryer.

Gazeta "Mokra": - Zoti Kryetar, jemi në muajin e 18-të të mandatit. Çfarë konsideroni si arritjen tuaj më të mirë, sidomos në vitin e shekullit të Pavarësisë?

Fuat Fero: Arritja më e suksesshme e imja është ajo që unë realizova atë që premtova, për të kthyer dinjitetin në vend çdo banori të këtij komuniteti, për të qenë i barabartë para ligjit dhe se administrata të jetë shërbëtoare në çdo moment, për këdo, pavarësisht ngjyrimin politik. Sot kush-

do që ka problem në komunë merr përgjigje dhe zgjidhje të menjëherëshme, pa u sorollatur nëpër zyra, si dhe ndërhyrje në terren për ballafaqim dhe dhënie të zgjidhjes në mënyrë ligjore. Jam ulur në karrigen e kryetarit si njeri i thjeshtë dhe kështu kam vendosur që të largohem. Që edhe kur të jem si gjithë të tjerët të shikoj e të më shikojnë drejt në sy. Tashmë une sot nuk jam kryetar partie apo shërbëtor i saj por jam kryetar i gjithë komunitetit dhe do të mbetem deri në fund shërbëtori i komunitetit.

Arritje tjetër të suksesit tim është se në bashkëpunim me Këshillin e Komunës, jo me shumicë votash, por me 100% te votave, kemi marrë e zbatuar vendime të rëndësishme për zgjidhjen e shumë problemeve të së shkuarës, siç janë hapje dhe zhbllokim i rrugëve të arave në të gjitha fshatrat e komunës, ku sot është i mundur futja e mekanikës bujqesore, vënia nën kontroll e veprimtarisë të së gjitha firmave shfrytëzuese të pasurive mbitorësore e nëntokësore etj. Deri tani nuk kam pasur asnjë rast të konfliktimit me këshilltarët e të gjitha forcave politike por i kam pasur krahë në marrjen e zbatimeve e vendimeve dhe jam i sigurt se kjo atmosferë do të jetë deri

në fund të mandatit tim si kryetar. Mund të flas dhe për arritje të tjera, për ato ç'ka janë bërë në të gjithë fshatrat, si në ndërhyrjet në ujësjellësa, ndriçimet rrugore, infrastruktura shkollore etj. Por nuk është e nevojshme që banorët e komunitetit ta lexojnë në gazetë, pasi ata i lexojnë çdo ditë duke i përjetuar në vendet ku jetojnë. Në këtë vit të shpalljes së Pavarësisë jam krenar bashkë me administratën që unë drejtoj se kudo kemi mbjellë bashkimin dhe vëllazërimin, duke i trajtuar njerëzit njësoj, sipas ligjit.

Gazeta "Mokra": - Po në perspektivë çfarë mund të arrini? Për shembull, rrugët ose ngritja e qenderave shëndetësore, të cilat mund të jenë pengua juaj.

Fuat Fero: - Desha të theksoj se për çdo nevojë të komunitetit, sipas fshatrave, janë përgatitur projektet dhe u janë dërguar institucioneve për kërkesë-financim. Po përmend disa prej tyre, si: shtrim asfaltimi i rrugës Golik-Propisht-Slabinjë, rrugë Qafa e Zhellarit-Rrodokal-Homezh, rrugë Rrodokal Sipër-Rrodokal Poshtë-Letovë, sistemim asfaltimi i qendrës së komunës Proptisht, e fshatit Vërrë, projekte shkollash e ujësjellësve etj. Por për këtë vit, nga ana e qeverisë për këtë komunë nuk u dha asnjë investim. Ne presim nga momenti në moment të jepet zgjidhja për ndërtesën e shkollës së mesme të bashkuar, në fshatin Rrodokal Sipër, ku mësojnë mbi 400 nxënës që vijnë nga fshati Rrodokal Poshtë e Homezh dhe se nxënësit janë shpërndarë nëpër dhoma me qera, në shtëpi private, kurse shkolla e Mesme u vendos në fshatin Homezh, ku nxënësit çdo ditë bëjnë rreth 2 orë rrugë në këmbë. Falë bashkëpunimit me shoqatën "Gjysmëhëna e Kuqe" e Emirateve të Bashkuara Arabe, janë në proces ndërtimi 3 qendra shëndetësore në fshatin Vërrë, Slatinë dhe Zall-Torrë dhe se shpejt jemi në pritje të ndërtimit të një ambulance tjetër në fshatin Homezh.

Po me këtë shoqatë kemi hyrë në bisedim dhe janë hartuar projektet për ujësjellësin e fshatit Rrodokal Poshtë si dhe me shoqata të tjera për ndërtim e objekteve të kulturës fetare në Slabinjë, Kriçkovë, Rrodokal Poshtë e Homezh.

Një ndihmë të madhe më ka dhënë dhe firma ndërtuese e Hecit Zall-Torrë, e cila lidhi me rrugë të gjitha shtëpitë e këtij fshati, vlera e së cilës arrin në 200 milionë lekë të reja. Jemi në pritje të ndihmës për të hapur një rrugë për të lidhur fshatin Slatinë-Debrovë-Selishtë me Zallin e Torrës dhe Golikun. Për këtë janë në plan të ngrihen 3 ura me bashkëfinancim të firmës ndërtuese dhe komunës.

Gazeta "Mokra": - Në bashkëjetesë, mokrarët janë popull i fisshëm. Jo se më djeg kurioziteti të di hollësi po a reflektohet mirëkuptim në vendimet e këshillit të komunës? Sigurisht kur e vërteta është mbi tavolinë.

Fuat Fero: - Pak a shumë përgjigjia e kësaj pyetje është dhënë në pyetjen e katërt, por po e ritheksoj se deri tani asnjë projekt-vendim i zyrate të administratës së komunës nuk është kthyer mbrapsh dhe falë mirëkuptimit, miratimi i tyre është bërë me shumicën dërrmuese, për të mos thënë 100% e këshilltarëve. Çdo projekt-vendim bëhet duke u konsultuar me grupin e këshilltarëve të fshatit apo zonës në të cilën pritet të merret vendimi.

Gazeta "Mokra": - Kam mësuar se viti shkollor filloi mbarë në shkollat e komunës suaj. Cilat ishin problemet që ju përballuan dhe, meqë jemi në 100-vjetorin e Pavarësisë, cila është ngjarja më mbresëlënëse për familjen apo jetën tuaj personale?

Fuat Fero: - Për të siguruar fillimin e mbarë të vitit shkollor në të gjitha shkollat puna për lyerjen dhe rregullimin e tyre filloi që në muajin korrik dhe çdo gjë është në normalitet të plotë, përjashtoj problemin e shkollës Rrodokal Sipër. Janë marrë të gjitha masat për ngrohjen e ambienteve në periudhën e dimrit. Për pyetjen e fundit dua të theksoj se unë çdo ditë jam në aktivitet të plotë, duke futur edhe ditët e pushimit. Nuk arrij të kuptoj se sa shpejt ikin ditët në këtë detyrë, duke qenë në kontakt me hallet e shqetësimit e njerëzve dhe pothuajse çdo ditë ka mbresat e saj. Gëzohej dhe jam i qetë në mbrëmje kur kam dhënë zgjidhje problemeve ashtu sikunder zgjohem e mbetem pa gjumë ku ndoshta edhe pse nuk jam fajtor për atë që dikush mbetet i pakënaqur nga zgjidhja qi i kam ofruar si kryetar komune.

Gazeta "Mokra": - Zoti kryetar, ju faleminderit për intervistën për të cilën ka nevojë gazeta.

Intervistoi: Haki BALLIU



INTERVISTË E DR. TË SHKENCAVE EKONOMIKE Z.PASKO VAKO DHËNË GAZETARIT LLAZI TONA

Situata demografike në Shqipëri, dukuri të mira dhe jo të mira

Disa fjalë rreth konceptit "Situata demografike"

(vijon nga numri i kaluar)

-Po shtypshkronjën "Mbrothësia" në Sofje nga kush drejtohej dhe cilat janë motivet e saj?

Nisma më e rëndësishme e shoqërisë "dëshira" ishte ngritja e shtypshkronjës në Sofje që drejtohej nga Kristo Laurasi e Kosta Trebicka. Në të u botuan disa libra si "Dritërefenjësi shqip" të cilën pas 1898 kryeredaktori Mithat Frashëri (Lumo Skëndo) i biri i Abdyl Frashërit e quajti "Kalendar Kombëtar" kurse Shahin Kolonja drejtonte gazetën "Drita" që filloi botimin e saj më 1901 dhe u bë më e rëndësishme në gjuhën shqipe. Libra të tjera ishin "Valë Deti", e Spiro Dinës, "Shqipëria çka qënë, ç'është e ç'do të bëhet" e Sami Frashërit, drama "Besa" po e Sami Frashërit, "Bagëti e Bujqësi" e Naim Frashërit dhe "Dëshirat e Shqiptarëve" po e Naim Frashërit. Në këtë shtypshkronjë u botuan mjaft gazeta e revista.

- Kolonia e Sofjes fitoi peshë dhe luajti rol të rëndësishëm. Në qëndër të Sofjes ndodheshin: "Hani i Dhimitër Males", "Kafeneja Albania", e Adhem Shkabës dhe Spiro Garos, "Hoteli Petersburgu" i Marko Kostandinit nga Grabova e Mokrës së Pogradecit në atë kohë, më vonë Raisa Llazarit, Jordanka Grabova e bija e LLazar Grabovës, njëri prej kryetarëve të mëvonshëm të "Dëshirës". Ç'mund të do na thoni për këto baza të lëvizjes Kombëtare?

Sofja u bë qëndra e rëndësishme e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, krahas Stambollit, Bukureshtit. Por Sofja duke qënë më afër shqipërisë kishte mendësi më të madhe lidhje e ndihmë për vendin tonë. Duke qënë e tillë Sofja është vizituar nga shumë patriot e luftëtarë të 'ështëjes kombëtare si nga vëllezrit 'er'iz e Bajo Topulli më 1906 të cilët qëndruan 6 muaj për të mbledhur e blerë armë. Më 1911 shkoi në Sofje Noli që bëri meshë në gjuhën shqipe, ku morën pjesë dhe shumë bullgarë, rumunë, grekë, vllahë, maqedonas që ishin në Sofje ve' shqiptarëve . më 1915 mbrin në Sofje Themistokli Gërmenji me 60 luftëtarë. Më 1910 emigroi në Sofje familja e shkrimtarit dhe atdhetarit Thoma Kaçori, kryetar i shoqatës "Skënderbeu" etj.

Për propogandimin e çështjes shqiptare kanë dhënë ndihmesën e tyre dhe personalitete të kulturës bullgare si Dhimitër Rizor, Perikli çiler, Nedjallko Kullushëv, Petër çululër etj, të cilët shkruan libra e artikuj për historinë,



Sipas fjalorëve shkencorë, situatë demografike paraqet gjëndjen e proceseve e dukurive demografike, përbërjet (strukturat) dhe vendosjen e popullsisë së vendit në tërësi në një vit ose periudhe kohe të caktuar. Përshkrimi i situatës demografike zakonisht përfshin karakteristikat e lindshmërisë dhe të ligjësisë të përgjithshme të riprodhimit të popullsisë, por gjithashtu dhe martesat, divorcet (ndarjet), forimin e familjeve dhe ngandonjëherë ndryshimet në përbërjet e popullsisë si premisë e rezultat, këtyre proceseve. Midis dukurive të ndryshimit të numrit të popullsisë, si rregull veçohet migrimi. Situata demografike formohet nën ndikimin si të ligjësisë të përgjithshme të riprodhimit të popullsisë, ashtu dhe të kushteve të tjera sociale dhe ekonomike të vendit me të cilat është e lidhur ngushtësisht.

kulturën e veprimtarinë e shqiptarëve. Bullgari ae priti me gëzim shpalljen e Pavarsisë nga plaku i mençur Ismail Qemali më 28 nëntor 1912.

- Nga vitet në shkollën e lartë që ju mbaruat në Sofje të Bullgarisë cilat janë mbresat që ju kanë mbetur për Bullgarinë?

Studentët shqiptarë në Bullgari shënuan një kapitull të ri në Mardhëniet tradicionale të popullit shqiptar dhe atij bullgar. Këta student që u përgatitën si specialist të aftë në fusha të ndryshme ndihmuan fuqimisht për njohjen e ndërsjelltë dhe afrimin e dy popujve tanë, që kanë lidhje të thellë nëpër shekuj, por një miqësi të vjetër. Të gjithë studentët kanë mbetur me mbresa më të mira për Bullgarinë dhe shprehin falenderimin më të thellë për ndihmën, miqësinë dhe mikpritjen e rinisë dhe të popullit bullgar.

Me nderim e respekt të veçantë kujtoj profesorët e mij bullgar të Institutit të Lartë Ekonomik të Sofjes si zotërinjtë: Zhak Nartan, Zhak Arojo, Totja Totar, Zdrafko Susarës prof. Zvrakov etj.

- Lexuesit e gazetës "Mokra" duan të dinë nga ju

diçka për historinë Trake e Bullgarisë.

Popullsia më e vjetër sipas dëshmive të shkruara që ka jetuar në Ballkanin Lindor kanë qënë Trakët. Në shekullin e I-rë trevat e trakëve e pushtuan prej romakëve, të cilët krijuan provincën e Trakës në jug të vargmaleve Ballkan dhe atë Moesisë apo Mesisë në very. Në shekullin VI në Trakë u dyndën paraardhësit e sllavëve të Ballkanit, kurse në shekullin VII avarët dhe sllavët u ngulën në ultësirën e Danubit duke ua kaluar trakëve në numer. Këta sllavë u shkrinë me bullgarët luftëtarë të ardhur nga Azia Qëndrore drejt Ballkanit, pasi qënë dëbuar nga e ashtuquajtura "Bullgari e madhe e vjetër" trevë midis Detit të Zi dhe atij Kaspik. Eelementët etnikë kryesorë të popullsisë qënë trakët, më pas u pushtuan nga sllavët e më tej parabullgarët. Vargmali Ballkan në jug të Bullgarisë, ka qënë djepi i shtetit bullgar, fushat pjellore në mes të Malësisë Qëndrore dhe maleve Rodope kanë qënë treva jetike e Trakëve dhe magneti që ka tërhequr pushtues si Filipi i maqedonisë dhe romakët si dhe

turqit në mesjetë. Ultësira e Trakës ka qënë me toka pjellore që në lashtësi.

Në epokën modern, pra në vitet 1919-1923 Traka u nda përfundimisht midis Bullgarisë në very, Turqisë në Lindje dhe Greqisë në Jugperëndim.

Nga fundi i vitit 2011 në Shqipëri u bë regjistrimi i popullsisë. Lexuesit e gazetës "Mokra" duan të dinë: Sa është popullsia në Shqipëri, ka rritje apo rënie të saj, sa popullsi jeton nëpër qytete dhe sa jeton nëpër fshatra?

Bazuar në të dhënat para-prake të censuesit të popullsisë dhe banesave të vitit 2011, popullsia e Shqipërisë ishte 2 831 741 banorë, nga të cilët 1 421 810 janë meshkuj dhe 1 409 931 femra. Në qytet jetojnë 1 521 907 banorë ose 53.7 % e popullsisë gjithsej dhe në fshatra jetojnë 1 309 834 banorë ose 46.3 %. Për herë të parë në historinë e censuesve të krijuara tek ne, popullsia urbane (qytetare) është më e madhe se ajo që jeton në zonat rurale (fshatra), duke u bërë kështu promotore e zhvillimit të vendit. Në këtë censues janë

numëruar 748 256 njësi ekonomike familjare, me një numur mesatar pjestarësh të një njësie prej 3.8 vetash (3.6 në qytet dhe 4.1 në fshat). Numuri i banesave gjithsej sipas censuesit ishte 1 075 881 banesa nga këto 411 266 banesa të banuara ishin në qytet dhe 311 215 banesa nëpër fshatra.

Ç'vend zë Shqipëria në emigracion duke krahasuar me vendet e Gadishullit Ballkanik dhe vendet e BE?

Ne kemi eksport të madh të fuqisë punëtore (emigrantëve) dhe për frymë të popullsisë zemë vendin e dytë në botë. Sot llogaritet të kemi lënë vendin më shumë se një një milion e gjash-të mijë veta ose 56.5% të popullsisë së sotme janë vendosur kryesisht në Greqi, Itali, SHBA, Kanada, Gjermani, Britani e Madhe etj. Në 2010 EUROSTATI deklaronte se vetëm në Europë ka mbi një milion shqiptarë të emigruar atje, që përbëjnë 5% të numurit të të huajve në 27 vendet anëtare të BE.


Sipas shpërndarjes gjeografike të emigracionit rezulton se afro 90% e emigrantëve shqiptarë janë vendosur në Greqi e Itali, kurse diferenca në SHBA, Kanada, Britani e Madhe, Gjermani etj. Në Greqi numuri i emigrantëve shqiptarë është mbi 750 000 veta. Ata kanë depozituar në banka mbi 2 000 000 euro. Në Itali në vitin 2010 ishin 482 627 emigrantë shqiptarë nga të cilët 220 773 veta ishin punonjës, 23 752 ishin biznesmenë. Dërgesat e tyre në vit ishin 135 580 000 euro. Të dhenat i jep Ministria e Brendshme Greke dhe Italiane.

Të rinjtë, vazhdojnë të emigrojnë tek ne se ka varfëri, papunësi, duan një jetë të sigurtë e më të mirë etj. Frenimi i emigrimit mbetet një sfidë e madhe për sot e për të ardhurën. Reduktimi i varfërisë dhe i pabarazive është rruga dhe mënyra më e mirë për të reduktuar emigrimin.

Ndërsa migrimi i brendshëm (nga fshati në qytet) pati edhe pasojë pozitive të urbanizimit (rritjes së popullsisë qytetare), pra urbanizimi është karakteristika më dalluese gjatë 22 vjetëve të fundit pasi në censuesin e 2011 popullsia qytetare për herë të parë e kaloi gjysmën e popullsisë, 54% të gjithë popullsisë, duke u bërë motor i zhvillimit ekonomiko-social të vendit.

Ç'mund të na thoni për punësimin në Shqipëri?

Punësimi tek ne është ende i ulët dhe kjo duke qënë se kemi popullsi në moshë pune të mad-



he, bënë që të kemi papunësi të lartë. Gjithsej janë punësuar 917 mijë veta në vitin 2010, nga këta 530 000 janë të sektorit të bujqësisë dhe 387 000 janë të atij rrobaqepësi. Në krahasim me vitin 2007 në vitin 2010 kemi një rënie të të papunëve gjithsej 22.000 veta.

Pra si rrjedhojë e këtyre kemi pakësim të të papunëve e shtim të papunëve, rritje të varfërisë, uljen e të ardhurave e punonjëse dhe konsumi i tyre ulet niveli i jetesës së popullit etj.

Për nga besimi fetar dhe nga kombësia sipas regjistrimit të popullatës të vitit 2011 në Shqipëri sa janë shqiptarë, grekë, vllahë, romë, bullgarë, malazezë, serbë?

Të dhënat për besimin fetar dhe kombësinë nuk kanë dalë akoma nga censuesi.

Cvend zë Shqipëria në botë, për lindshmërinë, për vdekshmërinë dhe në treguesit e jetgjatësisë mesatare?

Si kudo në botë, edhe tek lindshmëria (numuri i lindjeve për 1000 banorë të popullsisë) ka rënë. Nga faktorë determinues për trefishimin e numurit të popullsisë gjatë 44 vjetëve (1945-1989) ligjëshmëria sot ka rënë nën pragun e treguesit të riprodhimit të thjeshtë (2.12 fëmijë mesatarisht nga një grua e moshës 15-49 vjeç). Nga 6-7 fëmijë për një grua në vitet 1960. Sot një grua lind mesatarisht 1.6 fëmijë gjatë jetës së saj produktive (15-49 vjeç). Kjo ulje e madhe 4 herë e lindshmërisë u shkaktua nga rritja e nivelit të jetesës, nga urbanizimi i vendit, nga rritja e moshës së martesës, nga arsimimi i grave, nga ulja e vdekjeve të fëmijëve nën 1 e deri 5 vjet, nga rritja e divorceve, dhe aborteve, nga migrimi i madh i popullsisë në moshë riprodhuese, nga rritja e nivelit arsimor-kulturor, nga përdorimi i mjeteve të kontrollit të lindjeve etj.

Ne kemi sot numurin mesatar të fëmijëve për një grua (1.6) më të lartë se Serbia e Mali i Zi, dhe pak më lartë se Greqia e Maqedonia (1.4).

Kjo ulje e madhe e lindjeve krahas me emigrimin masiv e përkeqësuan mjaft popullsinë tone, e bënë më të moshuar dhe

më të plakur se përpara.

Në të ardhmen do të kemi më pak njerëz në moshë pune, më pak nëna e fëmijë dhe më shumë pleq dhe plaka, nuk do të jetë e largët as koha e barazimit të lindjeve me vdekjen dhe më pas do të kemi një shtesë natyrore (lindje minus vdekje) negative. Po kështu do të kemi familje më të vogla, më pak martesë, moshë mesatare më të lartë të popullsisë, shpenzime më të mëdha për pensionistët etj. Pra thellohet kriza demografike e vendit.

Vdekshmëria e përgjithshme tek ne është më e ulët se në Evropë. Nga 14 vdekje për 1000 banorë në vitin 1950. Sot ky tregues u ul nën 1 pjesë në 5 vdekje. Nga 143.1 vdekje për 1000 foshnja. Në renditjen e 181 shteteve për treguesin e zgjatjes mesatare të jetës, që bënte në 2007 CIA Amerikane, Shqipëria me 77.6 vjet mesatare zinte vendin e 34 në botë, të 25 në Europë duke lënë pas 18 shtete nga të cilat dhjetë anëtare të BE. Në shtetet e Europës juglindore zinte vendin e tretë pas Greqisë e Bosnjë- Hercegovinës. Nga viti 1938 e deri më sot zgjatja mesatare e jetesës tek ne është dyfishuar. Në 28 vëndet në tranzicion Shqipëria zinte vendin e dytë pas Bosnjë-Hercegovinës.

Faktorët e rritjes së jetës mesatare lidhen me rritjen e nivelit të jetesës, nivelit arsimor_kulturor, me zhvillimin e shëndetësisë, me luftën për uljen e sëmundjeve dhe të vdekjeve, me përmirësimin e kushteve të banimit e të jetesës, me urbanizimin e civilizimin e vëndit etj.

Nobelisti i vitit 2001 për mjekësinë Timonti Hunt thekson "Doni të dini përse është shtuar jetëgjatësia e njeriut në 30 vjetët e fundit? Për shkak të frigoriferit në shtëpi, ngrohjes, një ushqim më të mirë se më përpara dhe nuk punojnë nga 15-18 orë nëpër fusha. Ja kjo është arsyeja e vërtetë dhe jo mjeku.

Moshimi dhe procesi i plakjes së popullsisë në vëndin tonë?

Moshimi dhe plakja tek ne, që e kishim shumë të re ka filluar me nisjen e emigracionit ma-

siv të rinjtë tanë gjatë këtyre 22 vjetëve, pra këto procese kanë qënë të sforcuar dhe nuk ndalon se emigrimi vazhdon. Në afat më të largët do të kemi plakje më të theksuar, më pak fëmijë, më shumë të moshuar dhe një plakje të popullsisë aktive në moshë pune.

Moshimi dhe plakja tek ne erdhi nga pakësimi i peshës së të rinjve në popullsinë gjithsej, kryesisht nga emigrimi i tyre. Nga 34.8% që zinte grupmosha e të rinjve (0-14 vjeç) në 2001, në vitet e fundit zë 24%, grupmosha e punës (15-65 vjeç) nga 59% në 2001 aktualisht zë 57% dhe grupmosha e të moshuarve (65 e lart) nga 6% sot zë mbi 9%, pra ulen shumë të rinjtë dhe rriten të moshuarit dhe ata të moshës së punës, sidomos në veri e në qëndër të vëndit. Tek ne moshimi dhe plakja do të jenë më të theksuara, nga vitet 2020-2025, kur të futen në të moshuar gjeneratat e lindura në vitet e bebi bumit (1950-1960). Këto ndryshime do të shoqërohen me pasoja sociale si rritja e pensioneve, rritja e numurit mesatar të personave në ngarkim të një punonjësi me rritjen e shpenzimeve për të moshuarit.

Në vitet 2030-2040 do të ketë ulje të femrave në moshë riprodhimi si rrjedhojë e uljes së lindjeve në vitet 2000-2010 çka do të pakësojë edhe popullsinë e vëndit.

Studimi i OKB, botuar në World Population Ageing 2007 për Shqipërinë në vitet 2025 dhe 2050 jep plotësisht këto të dhëna për popullsinë: në vitin 2025 do të jetë 3 483.7 mijë banorë kurse në vitin 2050 do të jetë 3 458.1 mijë banorë.

Plakja e moshimi tek ne ka ardhur nga emigrimi i jashtëm, nga ulja e lindshmërisë dhe nga rritja e jetës mesatare të njerëzve.

Çfarë dukuri vihen re sot tek martesat në Shqipëri?

Martesa është procesi i formimit të çifteve bashkëshortore në tërësinë e njerëzve që përbëjnë një brez në tërësinë e brezave të popullsisë. Martesa si proces social demografik përcaktohet dhe rregullohet nga normat social-kulturore, aspektet

juridike, sociale, ekonomike etj, dhe është objekt studimi, një tezë shkencore shoqërore. Këtë fakt e vërtetojnë të dhënat e regjistrimit të vitit 2001, ku për moshat nga 35 në 70 vjet për meshkujt dhe nga 35 në 50 vjeç për femrat më shumë se 90% e numurit të popullsisë është e martuar. Burrat dhe gratë martohen në moshë të reja, midis 15 dhe 35 vjeç, dhe në moshat e larta pothuajse asnjë nuk mbetet beqar, duke u bërë kështu martesë për të gjithë një dukuri universale e shoqërisë tonë. Por edhe në numurin e martesave gjatë këtyre 22 vjetëve kemi rënie të numurit. Kështu, ndërsa në vitin 1990 kishim 28 992 martesë, në vitin 2008 numuri i tyre ishte 21 290, pra ka rënie në 26.6%, ndërsa në 1990 për 1000 banorë kishim 8.9% martesë, në 2008 vetëm 6.7%. Vetëm në vitin 2007 kundrejt vitit 1998 treguesi i martesave është zvogëluar më gati 25% kurse divorci është rritur me 39%.

Gjatë viteve të tranzicionit në Shqipëri divorcet në shqipëri janë rritur shumë. Divorci tek ne është bërë modë. Cilat janë shkaqet e tyre?

Divorci ose ndarja është procesi i ndërprerjes së jetës bashkëshortore si rrjedhojë e tronditjes së lidhjes martesore. Niveli i divorceve përcaktohet nga kushtet ekonomiko-shoqërore, atë familjare, nga normat social-kulturore dhe legjislatoni. Demokratizimi i familjes dhe emancipimi i grave shoqërohet me rritjen e nivelit të divorceve. Divorcet, në të kundërtën e martesave, janë rritur. Ndërsa në vitin 1990 kishte 2 675 divorce ose 9.2 për 100 martesë, në 2008 kishim 3 610 divorce ose 17 për 100 martesë, pra ato janë rritur me 35%. Divorcet më të mëdha vërehen më tepër tek çiftet pa fëmijë.

E keqja më e madhe është se divorcet vazhdojnë të shtohen çdo vit. Në vitin 2009 ishin regjistruar në gjykata 6 000 kërkesa për divorce, ku 1/2 i takojnë Tiranës, duke arritur kështu që mesatarisht çdo ditë të regjistrohen për ndarje 6-7 raste dhe nga shqyrtimi i tyre asnjë çift nuk ka pranuar të pajtohet

Divorce më tëpër bëhen në qytete, atje ka bum ndarjesh. Si shkaqje të divorceve gjykata paraqet: mospërputhjen e karakterit, tradhëtinë bashkëshortore, gjendjen ekonomike tepër të rënduar, emigrimin, papunësinë, dhunën, mungesën e arsimit etj. Numuri më i madh i divorceve shënohet në rradhët e emigrantëve për shkak të qëndrimit larg njëri-tjetrit. Të dhënat e mësipërme tregojnë se familja shqiptare është në krizë të thellë.

A ka krizë ekonomike në vëndin tonë?

Tek ne, ka krizë, e ajo thellohet vazhdimisht. Këtë e argumentojnë të dhënat e mëposhtme: Në 2-3 vjetët e fundit janë mbyllur shumë ndërmarrje ekonomike që ishin aktive, është rritur papunësia dhe varfëria, dërgesat e emigrantëve u ulën në 2010 në 696 milion euro nga 952 milion që ishin në 2007, investimet e huaja direkte u ulën, eksporti dhe importi i mallrave janë tkurrur mjaft, kreditimi i ekonomisë është ulur shumë, pra asaj (ekonomisë) po i mungon oksigjeni, kredia ka interesa shumë të larta, janë rritur kreditet e këqia (se s'kanë të ardhura bizneset që t'i shlyejnë), janë rritur shumë, mbi dy herë, ritmet e rritjes ekonomike (nga 5.4% në vitin 2007 në 3.3% në 2009), borxhi publik ka arritur nivelin më të lartë në 60% të PBB (Produkti Bruto të Brendshëm) nga 53% të PBB në 2007.

Produkti Bruto i Brendshëm për banorë në 2009 rritet në 2711 Euro nga 2785 Euro që ishte në 2008, varfëria është e ndershme, ka pabarazi të mëdha se 20% e familjeve më të varfëra marrin vetëm 5% të të ardhurave, kurse 10% e më të pasurve marrin 30% të të ardhurave. Pra, kemi pabarazim shumë të theksuar duke krijuar një hendek në rritje midis të varfërve e të pasurve, uljet konsumimi final se janë ulur të ardhurat e rritur çmimet dhe se 1 në 3 familje ka borxhe për të kthyer, janë ulur mjaft shpenzimet kapitale në buxhet dhe kërkohet të ulet edhe në 2012, borxhi i jashtëm në % ndaj PBB është rritur në 25-1% në 2010 nga 15.3% në 2007.

Buxheti i jashtëm që po i afrohet shifrës afro 4 miliard Euro, rritet vazhdimisht se rriten edhe interesat e tij. Nga ana tjetër për frymë të popullsisë, duke qënë se janë larguar më shumë se gjysma e saj jashtë, do të na takojë dyfishi i shumës për tu paguar nga çdo shqiptar që ndodhet në vend. Bujqësia është e prapambetur dhe e ka ulur mjaft prodhimin e saj, FMN për vitin 2012 deklaroi se do të jetë më i vështirë etj.

Thellimin e krizës e vërtetojnë edhe të dhënat e INSTAT-it për rënie e PBB me 0.2% në tremujorin e parë të 2012 ndaj tremujorit të parë të 2011, ku rënia më e madhe është në degët e prodhimit: Industria -19.3%, ndërtimi -17.6%, transporti-1.7%, posttelekomunikacioni -4.8% etj, çka do të bëjë që të ulet rritja ekonomike më tej. Krizës ekonomike e financiare i bashkohet edhe kriza demografike e Shqipërisë (emigrimi masiv, varfërimi, papunësia e lartë, pakësimi i popullsisë, plakja e moshimi i saj etj.

-Ju faleminderit dhe suksese!

NË 100 - VJETORIN E PAVARËSISË!

“Kushedi sa gjak do të derdhet për të lëvizur këta gurë”

(Coptimi i Shqipërisë në vitin tragjik 1913)

Bedri BLOSHMI

Sa gjak do të derdhet vallë për të lëvizur këta gurë” këto do të ishin fjalët që tha shqiptari i cili ishte marrë nga komisioni për zbatimin e marrëveshjes së Londrës . Pas Konferencës së Berlinit dhe pas marrëveshjes së Londrës mbërritën ndërkombehtarët që ishin zbatuesit e kësaj marrëveshjeje. Këta flisnin pak ,paguheshin me sterlina angleze ,me dinarë jugosllav dhe me dhrahmi greke. Ata caktonin kufijtë e rinj të Shqipërisë .Një shqiptar që bënte pjesë në këtë komision zbatonte urdhrat e këtyre dhe vendoste nga një gurë aty ku i thonin .Shqiptari i leckosur ,zbathur këmbët i kullonin gjak duke ecur nëpër gurë dhe një cantë të grisur me një copë bukë misri brënda.Sa herë që e urdhëronin të vendoste gurin shqiptari fliste me vete : -”Kushedi sa gjak do të derdhet për të lëvizur këta gurë “,këta gurë që ngjajnë si gurë varri.Kur uleshin të hanin drekë mbasi kishte ardhur mishi i pjekur në hellë e ushqime të tjera cilësore ,shqiptarin e ulnin larg i cili hapte trashëtinë e grisur dhe nxirrte që andej një copë bukë thatë e fliste me vehte : “Këta gurë se si më ngjajnë si gurë varri”.Ky shqiptar i lodhur, i rraskapitur e i pangopur as me

erën e mishit të pjekur apo të kockave që ishte pranë tyre, paguheshe shumë pak.Këta të pangopurit ecnin hipur në kalë qeshnin e bisedonin me njëri-tjetrin e shqyenin mishin e pjekur duke e shoqëruar me një gurmaz raki rrushi,i bënin me gisht shqiptarit që ta vendoste gurin atje ku i thoshin sepse gojën e kishin të zënë.Kjo krasitje e vendit tonë të dashur do priste plot një shekull që këta gurë varrezash të lëviznin, jo në interes të Shqipërisë por të shovinistëve grekë ,jo që ne të merrnim tokën tonë nga krimet e bëra në 1913 për këtë tokë që është derdhur lumenj me gjak ,për këtë tokë që u sakrifikuara mijëra shqiptarë në të gjitha kohërat ,për këtë tokë ,për këtë vend që u pushkatuan mijëra shqiptarë dhe fjala e tyre e fundit ishte :

- “Të Rrojë Shqipëria”, shkuan humbur .Dhe fjala e shqiptarit që vendoste gurët e varrit atje ku e kërcënonin nuk doli, u bë me një firmë nën tavolinën e “diplomacisë” Shqiptare për të kënaqur tashmë oreksin dhe grykësinë greke të radhës .Ministri i jashtëm një farë Luli firmos me ministrën e jashtme greke Bakojanis që ti falnin disa km detë dhe kjo firmë u bë e njohur nga media pas një viti.Të

jep të kuptosh se ky Luli i ministrisë së jashtme e kishte pronën e babait të vet .Megjithatë dhe kur e ke pronën tënde të trashëguar dhe për arsytet e tua do ta shesësh së pari do tu thuash vëllezërve ,kushërinjve apo të tjerë të afërm dhe nëqoftëse ata nuk e blejnë, atëherë ti mund të gesh njerëz më të largët dhe jua fal apo shet ndryshe.Po si pyete të afërmit tuaj jo që kërcet kal-lashi, por dhe ai i largëti nuk e blen tokën me probleme të tilla.Mbase un jam i nxituar në këtë problem që po ngre se Luli mund ta ketë pronën e babait apo të dhuruar me ligjin e famshëm komunist 7501.

Mbasi problemi mori dhenë nga mediat e shkruara dhe televizive, çështja vajti në gjykatën kushtetuese .Gjykata kushtetuese, e cila përbëhet nga kriminelë vrasës e disa janë apo bëjnë pjesë nga familjet terroristëve komunistë e rrezuan këtë marrëveshje tradhëtare votuan 9 me zero,që do të thotë se është varrosur e mbyllur për të mos e hapur kurrë më, pra deti mbeti i joni që e kemi pasur .Mirëpo dinakëria greke me kalin e Trojës nuk u ndal .Edhe pse ka një mijë e një probleme u shkatërrua ekonomikisht e probleme të tjera që tashmë dihen botërisht ,duke paguar dhe shqiptarët me pen-

sione të majme kush ndërronte emrin dhe deklaroheshe grek, kryeministri Samaras shkon në Europë për të lypur që mund të dalë nga kriza nuk interesohet ta mashtrojë apo të bëhet i besueshëm për kreditë që kërkon të hajë bukë por takon qeveritarët shqiptarë dhe i kërkon për të hapur e diskutuar prapë kufijtë detarë .Megjithëse ministri i jashtëm grek ka deklaruar se ne i përmbahemi marrëveshjes të vitit 2009.Pra de fakto greku e ka marrë atë sipërfaqe deti që e kërkon .Ndërsa de juro nuk ka nevojë se këtu sic e dimë të gjithë asnjëherë nuk zbatohen ligjet .Athina e kërkon detin shqiptar si kompesim për të na ndihmuar të pranohemi ne BE.Kushtet e KE ne i kemi vënë në zbatim ,hoqëm dënimin kapital,aprovuam ligjin e famshëm për homoseksualët ,gati e ka parlamenti dhe ligjin për hapjen e shtëpive publike e ku di un plot kërkesa të tjera të BE-së.Tani do të kënaqim dhe Athinën që këto vitet e fundit ka trazuar të gjallë e të vdekur sic është rasti i varrezave të kosinës diplomacia shqiptare hesht ka harruar dhe ligjin e famshëm të luftës ,diplomacia shqiptare as që e hap gojën.Na vrasin në kufi këtu heshtet ,prishin varrezat në Boboshticë hesh-

tje ,ku i do qejfi Janullatosit ngre kryqe e kisha, askush nuk e ndalon .Ka ndodhur disa herë që janë ndaluar shqiptarët të shkojnë në vendin e tyre të lindjes , në trojet e stërgjyshërve i kthejnë mbrapsh sepse në pashaportat e tyre thuhet një e vërtetë vendlindja CAMËRI ,”diplomatët “ tonë heshtin pra thënë shkurt çfarë ka kërkuar Athina dhe Janullatosi kanë shirë në Shqipëri .Të gjitha këto bëhen në emër të fqinjësisë “ shumë të mirë” midis dy vendeve. Megjithatë duhet zbuluar se çfarë kërkojnë fqinjët e tjerë Serbia ,Mali i Zi apo të tjerët që të bëhen fqinjë për ne për të hyrë në BE ,sic do bëhet dhe Athina.. KE ka kërkuar dhe për dënimin e krimeve komunistave, parlamenti hesht .KE ka kërkuar dhe kthimin e pronës tek i zoti,këtu heshtet .KE ka kërkuar të hapen dosjet e b.p.të sigurimit ,këtu heshtet.Të gjitha institucionet shtetërore janë mbushur me sigurimsa b.p. informatorë spiunë të cdo kategorie .Ndërsa parlamenti mbron diktatorin Hoxha duke mos ja hequr dekoratat ,të burgosurit politik janë hequr apo fshirë fare nga kujtesa e qeverisë .Interes të vecantë tregohet për bijtë e komunistave ,i punësojnë, i pasurojnë e ua plotësojnë oreksin si ta duan.Unë pyes :- A din kush të na thotë se ku po shkojmë ?

REGJIMENTI I POGRADECIT ISHTE I PARI QË SHKOI TË MBROJË KUFIRIN, NGA PROVOKACIONET E USHTRISË GREKE, NË GUSHT 1949

Nga Zenun FERO

Në gusht 1949, Greqia bëri shkelje të integritetit të Shqipërisë. Por në fillim të gushtit 1949 ajo mori rëndësi ekstreme, trupa të ushtrisë greke u futën në brendësi të kufirit shqiptar.

Firma e gjeneralit Zerves, me emrin Napoleon do të bënte që një brigadë këmbësorie e ushtrisë greke, artileri, tanke e aviacion të hidheshin në mbulim frontal ndaj vendit fqinj.

Për të mbrojtur territorin, Regjimenti i Pogradecit ishte i pari në veprime pas sulmit të ushtrisë greke, në fillim të gushtit 1949. Regjimenti i 26-të, i Pogradecit, me dy batalione u dislokua në Hoçisht të Devollit. Në atë kohë, provokacionet nga ana e grekëve ka në qenë në vazhdimësi, shkelje territori qëllonjë me armë, madje kalonin dhe aeroplanë mbi hapësirën tonë ajrore.

Mengjesin e 2 gushtit të vitit 1949 brigada 41-të e ushtrisë greke bëri një sulm frontal të befasishëm duke marrë postën e kufirit të Vidohovës , në lartësinë 1309 metra. Sulmi tokësor u shoqërua dhe nga ajri. Në postën shqiptare ishte vetëm një skuadër e armatosur me automatikë e mitraloza. Regjimenti i Pogradecit, i'u dha urdhër të rimarrin postën e kufirit. Nga dreka erdhën dy batalion, dhe u hapën në formacion luftimi. Me këto u bashkua edhe ushtarët e kufirit që ishin terhequr nga sulmi i befasishëm. Pas disa orë luftimesh, Regjimenti i Pogradecit e mori kuotën (Resul Bedo, gazeta “Shekulli,, 2 gusht 2012)

Grekët kishin marrë edhe një pikë tjetër në lartësinë 1441 metra. Artileria grekë qëllonte dhe predhat binin në tokën shqiptare. Pas Vidohovës, ushtria grekë i shtriu sulmet në një pjesë tejtër të kufirit, në Sektorin e Bozhigradit, në drejtim të Leskovikut etje.

Në këto kushte, shteti shqiptar mori vendimin për mobilizimin e ushtrisë në gjithë kufirin jugor. U lëshua një urdhër nga Enver Hoxha “Mbi moslejimin e kalimit të forcave monarko-fashiste në tokën shqiptare,,

Petrit Dumja, komandant i Divizionit të Korçës, ishte organizatori kryesor, dhe e shkeli vetë territorin pëllmbë për pëllmbë ku ishin zhvilluar luftimet dhe ku duhej përqëndruar forcat.

Pas kësaj erdhi Mehmet Shehu që e kishte dërguar Enver Hoxha, më vonë shkoj vetë Enver Hoxha për t'u njohur me situatën dhe vizitoi të plagosurit. Një heroizëm të lartë treguan ushtarët e thjeshtë e oficerat drejtues.

Në ndihmë të divizionit të Korçës, erdhën dy regjimente, një nga Vlora dhe tjetri nga Delvina, në thellësi kishte edhe shumë forca të tjera .

Në 7 gusht, luftimet u zgjeruan në vijën e kufirit nga mali i

Moravës në drejtim të malit të Gramozit, Vidohova u shëndërrua në një arenë të përplasjes shqiptaro-greke. Në piramidën numër një, 55 trupat grekë kishin mundur të mbildhen në territorin shqiptar dhe zhvillonin një betejë të ashpër me ato shqiptare, të përbërë nga një togë dhe një nënrepart i Ushtrisë Popullore. Ishte një betejë frontale ku forcat greke kishin zënë pikat kyçe. Një ditë më vonë forcat shqiptare arritën të largonin togën grekë.

Divizioni nr. 49, i Korçës, u hodh në sulm më 12-13 gusht sepse sulmet nga grekët u intensifikuan. Forcat shqiptare u drejtuan për në Bilisht. Luftimet u zhvilluan në Kapshticë. Në mëngjesin e 14 gushtit forcat grekë nisen një tjetër sulm. Brigada nr 41, e mbështetur me një regjiment artilerie dhe një skuadrije aeroplanësh”Spitfire” vazhduan sulmet. Këtë ditë forcat grekë hodhën shumë predha

artilerie në fshatrat shqiptare. Trestenik, Kapshticë e Cangonj-Devoll si dhe në Bilisht. Nga goditjet e artilerisë mbetën të vrarë dhe shkatuan dëme materiale.

Provokacionet vazhduan edhe më tej, por ishin më të dobëta .

Në bazë të librit “Yje të Pa shuara-19” autori Resul Bedo, nga rreth 49 provokacionet e ushtrisë greke në kufirin jugor të Shqipërisë, mbetën të vrarë 60 ushtarë, 25 oficerë dhe u plagosën 89 të tjerë. Ndërsa në bazë të dëmtimeve të mbledhura nga robërit e luftës grekë, forcat shqiptare i kanë shkatuar ushtrisë grekë mbi 300 të vrarë, me 500 të plagosur, ndërsa 270 të tjerë u kapën robër.

Regjimenti 26-të, i Pogradecit ishte i pari në veprim, për mbrojtjen e kufirit dhe u largua i fundit, mbasi u stabilizua gjëndja.

Pogradecarët e treguan veten se dinë të mbrojnë kufirin edhe në tokën e tyre.

MITOLOGJI, LASHTËSI, TRADITË. . .

"FLLAMBRA", FLAMURI I AROMANËVE

Të ruajmë e transmetojmë vlerat e virtytet e popullit tonë

Nga Koço PIHONI

Fllambra, kjo bimë dru shkure, njihet ndryshe në vëndin tonë edhe me emrin Gjëmbi i Ariut apo Ilcja. Në botë njihet me emrin Ashe në sistematikat e bimëve njihet me emërtimin Ilix. Aquifolium. Egzistojnë rreth 500- 600 varjete, është dru shkure, lartësia e tij shkon nga 5 deri 10 m rrallë deri më 25 m. Jetëgjatësia shkon deti në 500vjet rritet kryesisht si nën pyll në pyjet e ahut e të dushkut. Shkure përherë e gjelbër, vënd origjinën e ka nga Afrika e veriut dhe Azia, para periudhës akullnajore, ajo ka qënë e përhapur në gjithë Europën me ftohjen e klimës, tani ajo gjëndet e përhapur kryesisht në vëndet me klimë mesdhetare e kontinentale. Ilcja ka rritje të ngadalte, ka kërkesa për dritë e diellë, shërben si lloj druri pionere në vëndet e shpyllëzuara, rritet në lartësi nga 600 deri në 2000m. Ky shkure kultivohet edhe në kopshe botanikë si lloj dekorativ i quajtur Ilcja e Artë, Golden Holly gjethet e saja kanë kanë nuancë të gjelbër në të verdhë të florinjte. Gjethet e Gjëmbit të Ariut, kanë përdorim edhe në mjekësinë popullore si diuretike, përdoren kryesisht nga të sëmurë e veshkave, frutet kanë formë sferike, ngjyrë të kuqe, është e pasur me fruktozë e vitaminë C shërben si purgative, fruti shërben si ushqim për zoqtë të cilët bëjnë dhe përhapjen e saja me anën e farërave që ndodhet në frut. Nga ana ekologjike ka rëndësi edhe për strehimin e zogjve gjatë dimërit, mbasi është e veshur me gjethë gjithë vitin. Përshkrimi nga Ing pyjesh Avni Myrte.

* Përdoret edhe si dru zbukurimi në festime familjar si festat e Krishlindjes e në rituale Dasma, Pagëzime e ceremoni të rëndësishme të ruajtura nga lashtësia e këtyre popujve dikur paganë të cilët kishin përzgjedhur Emblenë Fllambërën për Flamurin e tyre!

Kjo është edhe arësyeja e objekti i këtij shkrimi, paksa të veçantë e pak të trajtuar. Ku ky dru pyjor ka pasur e katribute Emblematike, quhet dikur "Flamuri i Aromanëve" apo Arëmënëve, ku cdo përbërës i asaj, kanë simbolikë përfaqësimi: Ngjyra e gjelbër e gjethëve përfaqëson vazhdimësinë e jetës, shpresën dhe Shikimin të parit. Fruti kokrat me ngjyrë të kuqe simbolizojnë Dashurinë për jetën dhe shqisën e Dëgjimit.

Gjëmbave që rrethojnë si kurorë gjethen, ju atribohet aftësia e Mbrojtës së element i domozdoshëm për vazhdimësinë e jetës, prania e tyre besohet se ndikon në mbrojtje, mbarësi e në Shënjtërinë e Kurorës Martesore. Pema në vetëvehte dëshmon jetëgjatësi, përshtatje ndaj kushteve e dobishme, bamirëse. Ajo ju afroon strehë në të keq e në nevojë zogjve të pa mbrojtur në pyll.

Për ta bërë më të këndëshme, dëshiroj të përshkruaj disa rituale të jetës e traditës në këtë komunitet që në jeton në krahinat e qytetet e Shqipërisë, Fier, Lushnjë Myzeqe, Kavajë, Elbasan, Berat, Shpat, Grabovë, Strugë, Belicë, Pogradec, Mokër Lungë, Niç, Voskopojë, Voskop, Vithkuq, Korçë, Frashër, Përmet e gjithë andej në vënd pa përmëndur



praninë e tyre, kryesisht në të gjithë qytetet e vëndit dhe të shteteve në vëndet e Ballkanit, Evropë dhe më gjërë. Duke qënë dikur një etni e pastër e cila është bërë më pas, etni shtet formuese në të gjitha trevat e ballkanit, duke luajtur një rol emancipimi e zhvillimi në historikun e shoqërisë, qytetërimi të dukëshëm edhe sot, pas mbi 2000 vitesh duket ndikimi e civilizimin e atij qytetërimi të hershëm të asaj bote.

* **Origjina, koha e ardhjes, vënd vendosjet e Aromanëve në Gadishullin Ilirik.**

Është Perandoria Romake, Gadishulli i Apenineve vënd origjina e Arëmënëve. Ajo perandori në kohën e lulëzimit ka patue e luajtur një rol të rëndësishëm të pa tjetërsueshme në zhvillimin, përparimin, emancipimin ekonomik e shoqëror të gjithë Evropës por veçanërisht të Gadishullit Ilirik sot Ballkanik. Ky zhvillim është realizuar në sajë të projektimit ndërtimit e funksionimit të "Via Api" e njohur në teritorët Ilire me emërtimin Via Egnatia e cila nisej nga brigjet e Italisë sot qyteti i Barit dhe Ankonës në bregun tjetër, përballë të detit Adriatik, në qytetet e Epidamusi dhe Apolloni e prej andej, kjo rrugë zgjatej për gjatë për në epiqëndër në qytetin Skampa e vazhdon rrjedhës së lumit Shkumbin "Ordaj" nga delta e tij në det, deri në rrjedhën sipërore të tija duke u lidhur e bashkuar me shumë degëzime lidhëse me shumë krahina e qyteza, duke kaluar nëpër shumë teritore të cilat quajtur sot me një emër Shqipëri, Maqedoni, Bullgari, Rumani, Greqi Turqi, Persi deri në Jeruzalem e Mekë etj. Po kështu në perëndim, ajo arterie rrugore kalonte me Francën, Spanjën, Potrugali e kështu lidheshin vëndet shtetet njëri pas tjetërit. duke e bërë atë rrugë lidhëse me gjithë vëndet e Evropës

* **Projektimi, ndërtimi, funksionimi i saj kërkoi projektues, ndërtues, financime për qindëra puntorë për dhjetra e dhjetra vite, për të përballuar punimet zgjerime, shtirime rrugë me kalldrëm ndërtim urash, qyteza strategjike me infrastrukturën e kushtet e duhur banimi, shëndeti, shkollimi për familjet e asaj Administrate Doganore e Garnizonëve ushtarakësh të ngritura e vendosura për të siguruar lëvizjen e lirë të njerëzve e mallrave në gjithë gjatësinë e rrugës në teritorët ku ajo kalonte. Ajo ka diktuar krijimin e qytezave të cilat e bënin të mundur plotësimin e nevojave për strehim,**

ushqim etj, të cilat diktojnë për kohën ndërtime për nerëz e kafshë si banesa, restorante, kafene, hane, zhvillimin e zejeve, Dyqane Mishi, Bukë pjekës, Bulmetore, Koveçë - Nallban, Samarxhinj. Rrobaqepësa, Dru punuesa etj. Ajo vepër madhore "importoi" Punësim, Para, Dituri, zhvillim, aftësim, emancipim shoqëror në ato zona ku ajo kalonte për shumë shekuj më rradhë deri në periudhën e vontë të mesjetës si i vetmi mjet tokësor transporti për qarkullimin e mallrave, lëvizjen e njerëzve, kulturave, dokeve zakoneve e tjera. Kjo rrugë ka ndjekur zonat me rrjedha ujore, mbase duke ditur se atje ku ka rrjedha Ujore dete, liqene lumenj ka jetë, prodhim, begati e zhvillim prandaj u quajt e rruga "Via Api" që ndjek rrjedhat ujore

Kështu shpjegohet konkretisht dhe zhvillimi e rritja e dikurëshëm i qytezës të Llungës në pjesën sipërore të Lumit Shkumbin në Mokërën e dikurëshme. Kjo qytezë ka qënë dhe qëndër kryesore, sepse atje kryqëzoheshin e bashkoheshin degëzime të rrugës Egnatia, si ajo që nisej e vazhdonte nga Epidamusi, Skampa, Qukësit, Lungë etj. Një linja nga Llënga vazhdonte në Grabovë, Berat, Vlorë si dhe një linjë që shkante e vinte në Struga e Ohri Maqedonia, Bullgaria, Rumani, Turqi etj. Kjo është origjina e herëshme e bashkëjetesës, asimilimit të ndërsjellë edhe të vlerave genetike dhe e ndryshimeve e demografike ndër shekuj të lëvizjeve të atyre etnive latine nëpër etnitë bujtëse në Ballkanit e në shumë vise të Evropës më vonë. Ishin ata garnizonë ushtarakësh zanafilla e Templarëve të quajtur më pas ndryshe, Kalorësit e Kryqit të cilët u drejtuan për shumë kohë nga Kisha e Romës deri në vitin 1054 vit ky kur Kisha e Krishterimi u nda në dy Kisha, Katolike e ajo Orthodhokëse me Selitë e Shënjtë të tyre në Romë, Vatikanin me Primat të Kishës Katolike Papën dhe Sinodin e saj të Shënjtë të përbërë nga jo më pak se Tre Kardinalët - Peshkopë. Dhe Kisha Orthodhokëse me Selinë e Shënjtë në Kostandinopojë, edhe sot Patriarkana e Stambollit me Primat të Kishës Patriarkun dhe Sinodin e Shënjtë me jo më pak se Tre Dhespotë, të cilat në shekuj e shtirë autoritetin e pushtetin e tyre në rajone të ndryshme të botës. Nda-si këto që përkohë edhe me kryqëzatën e Islamit kundër Krishterimit në vëndet Arabe. Për të cilët thuhet se 300 vjet pas kryqëzatës Islamike të vitit 1090 - 1100 kundër hebrejve

dhe arabëve të Krishterë. Nga ajo Kryqëzatë ata Islamikë dolën fitimtarë besimi Islami u bë dominues në vëndet Arabe. Në atë kohë thuhej se "Arka e Urdhëresave të Zotit" ndodhej e fshehur dhe e ruajtur prej disa besimtarëve të Krishterë prej më se 300 vitesh, ata vendosën që për siguri e besim, me qëllim që ajo dhuratë e Zotit të mos binte në dorën e besimtarëve të fesë Islame, prandaj ja u besuan atë "Arkën e Urdhëresave" një njësi prej atyre Kalorësive të Kryqit me besim për ta shpëtuar atë. Nga këta kalorësia për të cilët flitet te janë fillat e besimit të Masonierëve që predikohet sot. Flitej se ata Kalorës me gjithë se më pas u persekutuan e u vranë nga Inkuzicioni i Papës së Romës, nuk e dorzuan atë dhuratë me objekte dhe 4 librat e Shënjtë të ndodhura në atë arkë. Për vënd ndodhjen e asaj sot aludohet shumë. Por e vërteta është se ajo "Arkë" u transportua sipas porosive të dhëna atyre Kalorësive në vënd banimin e përzgjedhur për "Tempullin" e tij nga Zotit vet mbi këtë dhe. Ajo tokë e përfolur është Enkelana me popullin e përbërë të saj Enkelejtë. Atje është vënd ndodhia e Tempullit të Perëndeshave. Mal ky i quajtur Kozi që do të thotë i deshifruar "Jezu Krishti është i Biri i Perëndisë e Zoti Vetë". Ky Mal i Shënjtë ndodhet në Ilirinë e poshme në pjesën sipërore të pellgut ujëmbajtës të Lyhniidës, ky vënd është vënd lindja e vënd ndodhja e Manastirit të Shën Marenës e quajtur "Bijë e Shënjtore e Krahinës tonë" sipas lirikut tonë të madhit Lasgush Poradeci.

Sot për çudi në "apsurditet të plotë" kërkohen të sajohen lloj lloj "pakica" shtetërore a kombëtare, ku ky komuniteti i Arëmënëve të cilët janë popull tashmë autokton e shtet formues në cdo njërin prej shteteve relativisht të rinjë të Gadishullit Ballkanit. Banorë të herëshëm me vlera të pa tjetërsueshme në Gadishullin Ilirik prej mijëra vjetesh, kur asnjë shtet nga këta të sotmit të shpallur a të emërtuar sot nuk kanë ekzistuar.

* **Versioni Arumun i këtij komuniteti.**

Popujt më të vjetër në gadishullin e Ballkanit kanë pas qënë Ilirët, Thrakët, Helenët, Thrakët kanë pas qënë banorët e Thesalisë ku ndër popujt e sotëm që përfaqësojnë atë komunitet janë Rumunët dhe Maqedonët popuj këta të lashtë ballkanas jo sllavë dhe duket me origjinë neo latine të çvendosur mbase nga gadishulli i Apenineve. Degë e këtij fisi janë Dakët të cilët kishin vënd banim Vllahinë e Moldavinë " të ndodhura në dy anët e Danubit " gjatë lulëzimit të Perandorisë Romake ajo i forcoi lidhjet vecanërisht me këtë popull si komunitet dhe krijoi një qëndër të dytë të sajën e cila mori dhe emërtimin prej Romës në Romani një Romë e dytë kjo edhe për shkak se ky komunitet ishte shumë i përafërt me ta në shumë të dhëna nga gjeneza e tyre e largët. Ky vënd për shumë kohë njohu një zhvillim e lulëzim të pa parë, por duket se mbas rënjes së Perandorisë Romake në shek e IV- V nga dyndjet e pushtuesve Sllavë. Kjo bëri që mbas asaj disfate në të cilën u derdh shumë gjak, pushtuesit sllavë ishin të vendosur ti nënshkonin e konfiskonin me egërsinë më të madhe, Elitën e këtij populli që

përbënin parinë e vëndit dhe mbështetësat e tyre, kjo ishte dhe arësyeja e detyruar për shpërnguljes e largimit nga trojet e tyre në formë eksodi masiv e popullsisë të këtij komuniteti, duke marë me vehte pasurinë e tundëshme sikurëse ishin metalet e çmuar, gjënë e gjallë e doemos traditat, kulturën, dajën e zejet e tyre, duke u vendosur në troje të reja banimi duke ndjekur kryesisht rrjedhën e degëzimit e Rrugës Egnatia me drejtim drejt brigjeve të vënd origjinës të ndodhur përtej Adriatikut, duke u vendosur në trojet e Greqi, Maqedoni, Shqipëri e të tjera vënd vendosje. Ky komunitet i shpërngulur që përbënin dhe elitën e atij komuniteti tashmë mbas kësaj mbi vendosje në viset e reja krijoi "kolonitë" e saja Arumune, Dako-Romane = Arumunë, Dako-Helenë, Dako-Ilire, Dako-Maqedonas etj

Nga ky komunitet kanë dalë me dhjetra filozofë, perandorë, strategj ushtarakë, poetë e personatitete me famë botërore edhe sot. janë komunitet shume vital e dinjitoz Ky komunitet ka nxjerrë, krahas personaliteteve më përmasa botërore në shumë fusha të dijës, dhe shumë tregëtarë e mjeshtrë prodhues ku dallohen në mbarshkrimin e kafshëve të punës e prodhimin si dhe përpunimin e prodhimeve e nen produkteve të tyre si bulmetin, leshin, lëkurët, brirët, terëzinj, samarxhinj, qilima punuesa, qirinxhinj, dru qumisa etj

Nga ajo kohë, edhe sot janë ruajtur disa zakone e doke të cilat dëshiroj ti bëj të njohura për lexuesit kureshtarë për atë periudhë të shkuar të historisë e cila na shoqëron edhe në ditët tona

* **Dasma!**

Në ditën e parë të javës së dasmës, ditën e Hënë disa nga të afërmit e dashamirës nga fshati, shkonin të organizuar atë ditë në pyll për të prerë dru të cilat do përdorëshin për pjekjen e bukëve, mishërave në hell e ngrohjen për dasmorët nëpër konakët në ditët e netët e dasmës.

Në krye të atij karvani printe një djalë i vogël adoleshent i hipur në kalë të zbukurua me shami që në këthim nga pylli, ai mbante pemën e prerë të fllambërës si Flamurtar. Pas atij vinte karvani i kuajve të ngarkuar me dru me të zotët e tyre pas. Në hyrje të fshatit karvani pritej me këngë nga disa burra e gra të të zotit të dasmës Më pas pema e Fllambërës vendosej në pjesën e sipërme të portës së shtëpisë e stoliset me pambuk e vendoseshin karamelle, mollë e fruta të tjera. Nën pemën e Fllambërës e zonja e shtëpisë pret Nusën e Dhëndërin ju uron fat e mbarësi. Pastaj e zonja e shtëpisë i jep Nusën një bukë të bërë me qigëra dhe një tas me mjaltë. Nusia ulet e puth pragun e portës. "Nuse ku kalle këmbën, aty të rënshin dhëmbët". Nusia i jep Vjerës një lugë me mjaltë e Vjera bën të njëjtën veprim. Më pas Nusia këput disa kokëra Mollë të varur në Pema e Fllambërës dhe i hedh në mes të turmës së dasmorëve kryesisht në grupin e vajza të pa martuara, molla sjell fat për atë që do ti bjerë e do ta kapë. Nusia lye me mjaltë portën para se të futë këmbën e djathtë brënda pragut në shtëpinë e saj të re tashmë. Rrite e këngë dasme sipas Llazi Tonës nga Llunga e Myrtesha Shahin Maxharit fshati Osnat, fshatëra që lidhin Mokërën me Gorën këto krahi-na simotra të përjetëshme.

(Vijon ne faqen 8)

PROFIL/LIBRAZHDI: SADI HALILI, NJERIU QË VALLËZONTE PA KËMBË

Shuhet mjeshtri i valles dyshe

Ndahet nga jeta në moshën 68-vjeçare koreografi i njohur i Librazhdit Sadi Halili. Mjeshtri i koreografisë së valles dyshe në Shqipërinë e Mesme, edhe pse pa këmbë, jetën e tij ia ka kushtuar valles. Veç krijimtarisë së tij si koreograf, Sadiu ka botuar edhe librin "Librazhdi në këngë", një botim me ballada, këngë trimërie, ninulla, këngë humoristike dhe lirike të mbledhura në gjithë krahinat e Librazhdit. Pjesëmarrja e tij në festivale ka qënë e përvitshme. "Vallja dyshe" e koreografit Sadi Halili njihet edhe në festivale mbarëkombëtare si, Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, Francë, Zvicër etj. Sadi Halili, koreografi dhe mjeshtri i valles dyshe, është vlerësuar me çmime të shumta gjatë karrierës së tij.

Sadi Halili, i cilësuar mjeshtri i koreografisë së valles dyshe në Shqipërinë e Mesme, në 40 vjet jetë artistike realizoi dhjetra koreografi të njohura jo vetëm në Librazhd, por edhe në qytete të tjera të Shqipërisë, madje edhe jashtë kufinjve.

"Është e kotë të besosh se valltarët janë të gjithë elastikë, njerëz me këmbë të fuqishme, apo që dijnë të koordinojnë lëvizjet e këmbëve dhe të duarve, pasi ka edhe shumë të tjerë si unë", ka thënë dikur Sadiu, i cili pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi i ulur në karrige me rrota.



Në qytetin e Librazhdit të gjithë e respektonin Sadiun dhe kudo ku kalonte karroca e tij e invalidit kalimtarët ndaleshin dhe respekt të përshëndesnin mjeshtrin, të cilin mesditën e sotme e përcollën për në banesën e fundit. Sadi Halili i ndërroi jetë në ditën e djeshme

në moshën 68 vjeçare nga një sëmundje e pashërueshme. Ai ishte gjithnjë në kërkim të formave të reja, të melodive të reja për t'i futur më pas të gjitha këto në një koreografi të veçantë. Me vullnetin e tij, ai ia doli që të mos e ndjente fare mungesën e këmbëve, këtyre gjymtyrëve krye-

sore për një valltar. Një aksident në punë në rini të tij, i shkaktoi edhe sëmundjen Halilit. Mjekët u detyruan që t'ia presin këmbët, por kjo nuk shkaktoi asnjë shqetësim në profesionin e tij. Gjatë 40 viteve të karrierës së tij, 20 prej të cilave pa këmbë, Sadiu vuri në skenë rreth 80 valle me

motive të trevave të Librazhdit dhe krahinave të tjera të Shqipërisë e Maqedonisë.

Përveç krijimtarisë së tij si koreograf, Sadiu shkruante edhe për vallen. Pesë vjet më parë ai botoi librin "Librazhdi në këngë", një botim me ballada, këngë trimërie, ninulla, këngë humoristike dhe lirike të mbledhura në gjithë krahinat e Librazhdit. Festivalet e tij ishin të përvitshme, "Vallja dyshe" e koreografit Sadi Halili njihet edhe në festivale mbarëkombëtare si Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi. Vallja e tij e parë "Elektrifikimi" u vlerësua me çmimin e parë në takimin e Ansambleve të Shtëpive të Kulturës organizuar në qytetin e Vlorës, valle e cila ka kaluar edhe kufijtë e vendit si në Francë, Zvicër. Përveç grupit të të rriturve mjeshtri i koreografisë kishte hapur edhe një grup me tetë çifte valltarësh me moshë 10 vjeç. Në shenjë mirënjohjeje qytetarët e Librazhdit propozuan dhe tre vjet më parë bashkia e qytetit i dha Sadi Halilit titullin "Qytetar nderi" të Librazhdit.

Sadi Halili, koreografi dhe mjeshtri i valles dyshe është vlerësuar me çmime të shumta gjatë karrierës së tij, me dy urdhëra të Naim Frashëri II dhe III -të, në vitin 1989 titullin "Artist i Merituar" në vitin 2002, titullin "Qytetar nderi" i qytetit Librazhdi. Me vendim të Presidentit të Republikës në vitin 2005 merr titullin "Mjeshtër i Madh".

NË KUANDRIN E 100-VJETORIT TË PAVARËSISË TË ATDHEUT

Luman Leka, atdhetari i shquar mokrarr

Nga Sami LEKA

Ashtu si gjithë krahinat e Shqipërisë edhe krahina e Mokrës ka lindur e rritur bij e bija që me punën dhe luftën për liri e demokraci, nderuan vetën, fshatin, krahinën e Shqipërisë. Me dhjetra e qindra Mokrarrë me armë dhe dije e sakrificë kanë lënë gjurmë të thella e nuk harrohen. Kështu ishte biri i shquar Luman Leka nga fshati Senisht që jetën e tij ia kushtoi Atdheut.

U lind në fshatin Slatinë. Ende i palindur i ndjeri nuk mundi ta shohë babanë e tij e as baba të birin, mbasi i ati ndërroi jetë. Mbas disa vjetësh i vdiq edhe nëna e tij. Lumani u rrit jetim. Për të u kujdes xhaxhai i tij, Fejzo Leka, i cili e mori për ta rritur. Por, mbas vdekjes së Fejzës e mori Selim Leka. Në familjet që ai u rrit mori edukatë e sjellje të mira nga ato nëna që e rritën dhe e edukuan. Vuajtjet e kalitën Lumanin që të urrente regjimet e pushtimit osman, apo copëtimin që donin të bënin shtetet fqinje Shqipërisë.

Në biseda me njerëz të ditur e të mençur ai mori mësim

shumë të vlefshme, ato mësim që predikonin rilindësit tanë të pavdekshëm të çdo kohe.

Por ajo që e gëzonte popullin shqiptar, Lumani ndiqte bisedën që Ismail Bej Qemali erdhi në Vlorë dhe bashkë me shumë trima Shqiptarë ngriti flamurin shqiptar. Nga këto biseda Lumani krenohet. Në luftën e Parë Botërore familja e e tij, ashtu si e gjithë Mokra, ka vuajtur shumë. Atë e internuan në Tetovë, në Shkup, në Kumanovë e deri në brigjet e Danubit, si muhaxhir.

Në mbarimin e Luftës së Parë Botërore, familja e Lumanit u kthye përsëri në fshatin e tij siç bënë të gjithë të shpërngulurit. Në kushtet e vështira ekonomike, Lumani u detyrua të punojë për bukën e gojës në disa fshatra, si në Starovë, në Qukës etj, për të siguruar kafshatën e bukës. Shumë banorë nga fshati Slatinë u larguan në thellësi të Mokrës, si p.sh në Senisht, ku kishte kushte më të mira për rritjen e zhvillimin e blektorisë.

I edukuar dhe rritur në një familje me ambient patriotik e atdhetar, Lumani u lidh që shpe-



jt me lëvizjen Antifashiste Nacional-Çlirimtare dhe komandantin e çetës së parë të Mokrës, me "Heroin e popullit" Reshit Collakun. Me krijimin e njësitit partizan të fshatit Senisht, në muajin nëntor të vitit 1942, ai zgjidhet Komandant i njësitit të fshatit, detyrë të cilën e kreu kurdoherë me besnikëri, trimëri e guxim. Mori pjesë në shumë aksione të luftës. I gjithë fisi "LEKA" mori pjesë në luftën për

liri, duke dhënë kontributin e tyre të vyer. Pjesëtarë të saj morën pjesë në luftë si Selimi, Beluli, Bariu, Arshimi, Dervishi, Fezua, si dhe Ganiu që ra dëshmor e dha jetën për çlirimin e vendit, në radhës e Brigadës së Parë sulmuese. Përkrah fisit Leka, u rreshtuan edhe fiset Isufaj, Hyseni, Murati, Alla, etj, të cilat hapën dyert e ndihmuan luftën me ushqime e veshëmbathje.

Shtëpia e Lumanit u plaçkit e u dogj nga okupatorët gjermanë, por Lumani nuk u ligështua, përkundarzi, ai u bë më i fortë së bashku me bashkëfshatarët që luftuan për liri.

Lumani, me bashkëshorten e tij, Sherifen, lindën e rritën Marjamin, Xhaferin e Feriden, të cilët kanë punuar mirë dhe sot janë me pensione.

Për merita të veçanta, Lumani është dekoruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Dekoraten e Çlirimit dhe atë të Trimërisë. Mbas çlirimit të Atdheut bashkëfshatarët e zgjedhën kryetar të këshillit të fshatit Senisht. I donte njerëzit dhe jetonte me hallet dhe shqetësimet e tyre, i gatshëm në çdo çast. Jepte ndihmesën e vet

për njerëzit në hall e në nevojë. Lumani i respektonte dhe e respektonte. I dëgjonte dhe e dëgjonin. Të gjithë këta lartësonin emrin dhe personalitetin e tij. Gati 20 vjet kreu detyrën si kryetarëshilli në fshatin Senisht.

Në vitin 1972 Lumani erdhi më banim familjarisht në qytetin e Pogradecit. Qejfi nuk ja kishte për ta lënë fshatin, por erdhën djemtë me punë në Pogradec dhe erdhi bashkë me ta. Herë pas here dilte çdo mëngjes e mbrëmje, pinte kafe me veteran të L.N.C, kujtonte luftën, të rënë për liri dhe trimërinë e tyre.

Lumani ishte i apasionuar pas këngës popullore. Gëzimet dhe hidhërimet ai i shoqëronte me këngë. Veçanërisht këngët e luftës, të "Heroit të Popullit" Reshit Çollaku që e këndonte me mall të madh. Në mënyrë të artistike ekzekutonte këngët humoristike me një mjeshteri të rrallë. Ai u nda nga jeta më 29 shkurt 1984.

Lumani do të mbetet i paharruar midis fëmijëve, nipërve, mbesave, miqëve e njerzve që e njihnin në Mokër, fisnik e bujar, trim e guximtar, Atdhetar i pashuar.

Xhaferi i Files

Istref HAXHILLARI

Kur vdiq Xhaferi i Files, askush nuk e besoi. I fortë, i pa sëmurrur ndonjëherë më parë, i mençur si ai askush tjetër. Kish-te pritur e përcjellë shumë më të rinj se ai, ndaj njerëzia besonin se qe i pavdekshëm. Ai nuk mund të vdiste edhe se i duhej fshatit. Kush do të zgjidhte hallet e koklavitura dhe shtëlliditë e njerëzve? Po sherret e grindjet që nuk kishin të shterur?

Fjala e mençur e plakut qetësonte shpirtat e trazuar, njëlloj me ilačin që shërrohte plagët e trupit. Si mund të ikte, kur duhej të mbante këtë barrë të madhe ashtu si vite e vite të tëra? Jo nuk duhej të vdiste. Ishte më i fortë se vdekja.

Nuk u besohej edhe kur e shihnin shtrirë në mes të odës, si të qe i gjallë. Ja, sa të dremiste pakëz dhe do të zgjohej. Po xha Xhaferi kishte ikur përgjithnjë në jetën tjetër, ku një ditë vemë të gjithë, duam apo s'duam.

Kush ishte ky burrë që bëri kaq përshtypje me vdekjen e tij, jo vetëm në fshat, por edhe përtej tij?

U lind shtatëdhjetë më parë në Dunicë, mbi të cilën rëndojnë një varg malesh të heshtur. Kozici në lindje, mali historik më i famshëm i Mokrës flet edhe sot e kësaj dite me gjuhë perëndish. Si rrallë tjetër, ujërat e tij burojnë në çdo cep, të kulluara, të ftohta dimër e verë. Ja aty përfund Kozicit, në brigjet e lumit Aradovë, lind dhe jetoj Xhaferi i Files.

Thonë se në të ri qe ca i prapë. Djalë i ri, rrotull njëzet vjet, pa një ëndërr të çuditshme. Engjëlli i tha në gjumë se duhet të martohej me një çobankë, përndryshe jeta e tij do të këputej shpejt. U zgjua i lebetitur.

Ku ta gjente çobankën një mysliman i mburitur nga ligje të rrepta? A do ta pranonin të tijtë nusen e krishterë, për më tepër llaukë me dy gjuhë? Po jeta është e shtrenjtë dhe djaloshi vendosi të veprojë.

Iu drejtua një shoku vërsnik, trim i njohur.

-Do të më ndihmosh, Avdi, - i tha me sytë përdhe.

-Hair ishallah, - u përgjigj Avdiu.

-Duhet të mbetet mes nesh, - i kërkoi, - më jep fjalën.

Tjetri iu betua të ruante të fshehtë. Si e dëgjo me vëmendje deri në fund i tha:

-Çobanka gjen në stanet dhe janë perri. Pse të mos vemi të rrëmbejmë një?

U nisën të armatosur me dyfegjet e kohës, zunë pusi përmby stanet në Qafën e Shelegëve. Pritën deri sa doli një çupë me enët në duar të mbushte ujë dhe e rrëmbyen. Dikush i pa, vuri alarmin dhe një tufë burrash iu vu pas djemve të çartur.

-Lëshojeni vajzën se nuk dilni të gjallë matanë bregut të Dunicës, - i paralajmëruan.

-Këtë do ta shohim, - ua ktheu Avdiu dhe nisi luftën.

Xhaferi qëllonte kuturu me dorën e majtë se të djathtën e kishte të zënë më vajzën. Burrat



e stanit qëllonin me kujdes, nuk donin t'i lëndonin.

Pas një ore Xhaferi u tërhoq. -E lëshojmë, - u thiri, - po të largoheni ju.

-Ke fjalë burri? - e pyeti vajza.

-Nuk dua nuse me zor, - ia ktheu Xhaferi, - thuaju të tërhiqen.

Vajza i besoi dhe u foli burrave në gjuhën e saj. Kështu përfundoi kjo histori çapkëne. Lajmi mori dhenë, po nuk pati pasojë të tjera. Madje thonë se më pas Xhaferi i bëri miq çobenët dhe u kërkoi ndjesë për marrëzinë e moshës së hershme.

Ëndrrat nuk dalin ose njerëzit më zor e kuptojnë kumtin e tyre.

Xhaferi u martua me një myslimankë që e desh shumë, po Zoti ia mori shpejt, i la një djalë. Atëherë u martua për së dyti, bëri një tufë fëmijë dhe jetoj shtatëdhjetë vjet. Kur kujtonte rininë e parë thoshte me lezet:

-Më mallkoi çobanka të marto-

hesha dy herë, po edhe më mësoi të sillem mirë pas asaj marrëzie.

Dhe me të vërtetë ajo që e dallonte Xhaferin e Files nga burrat e tjerë të fshatit ishte sjellja e tij fisnike prej zotërie. Nuk e panë kurrë të vrenjtur, apo të thoshte një fjalë të keqe. Si një mësues i zoti i edukonte fëmijët e tij dhe të tjerët të silleshin si duhet, të përdornin fjalë të kulturuar, të ndihmonin e respektonin të tjerët.

-Kur të thërret dikush, përgjigju vetëm "urdhëro", na thoshte përherë babai, - kujton Niazi, i biri i Xhaferit. - Një herë e dëgjoj motrën të përgjigjej si të tjerët në fshat "hë moj ç'ke" dhe e thirrri në odë i bëri një orë mësim, derisa ajo e hoqi atë fjalë dhe përgjigjej me "lepe", siç ishte e modës në atë kohë për njerëzit e kulturuar.

Jo vetëm fëmijëve të tij por edhe të tjerëve u jepte këshilla me vlerë dhe ata nuk i harronin

kollaj. Seç kishte një pamje të ëmbël që i detyronte vetiu të gjithë ta dëgjonin dhe të ndiheshin keq kur ai i qortonte.

Unë, fëmijë i parritur atëherë, e prisja me padurim të kalonte përmby avlli. Më thërreste xha Istref, se më kishin vënë emrin e gjyshit. Zakonisht mbrëmjeve dilte në qendër të fshatit dhe nuk harronte kurë të fuste në xhep ndonjë dardhë duckë apo kajakushkë të madhe nga ato të Aradovës. Dëgjoja zërin e ëmbël e të butë të xha Xhaferit:

-Ku je, xha Istref.

Unë përgjigjesha si ç'më mësonte ai.

-Urdhëro xhaxha, këtu jam.

-Pa dil këtej, - qeshte me gjithë shpirt, i kënaqur sa s'bëhej.

Vrapoja sa më hanin këmbët, e përqafoja fort. Ai më jepte dhuratën e përhershme.

-Duhet të bëhesh djalë i mirë se ke emrin e gjyshit. Po të sillesh keq e turpëron edhe atë dhe kockat atje në varr nuk gjejnë qetësi.

Unë përpiquesha me të gjithë forcën time prej fëmije të silleshja sa më mirë, të thosha vetëm fjalë të mbara që të mos turpëroja gjyshin dhe atij t'i rrinin kockat rehat në varr. Në të vërtetë doja të bëhesha djalë i mbarë edhe që xha Xhaferi të më lëvdonte dhe të më jepte ato dardhat ducka.

Pedagogjia e thjeshtë e xha Xhaferit kishte efekt të madh jo vetëm për mua por edhe të tjerët se buronte nga shpirti i tij qelbar, ishte e besueshme dhe nuk harrohej kurrë. Brezi im mban mend raste pafund të kësaj pedagogjie të vlefshme dhe asnjëri nuk mund ta harrojë burrin e mençur dhe këshillat e tij.

Grindjeve në fshat, të shpeshta aso kohe, Xhaferi kishte aftësi të lindur t'u vinte fre dhe bënte atë që nuk e bënin dot ata që e kishin për detyrë. Puna dhe jeta e përditshme e kalitën xha Xhaferin, mençuria e natyrshme i dha autoritet, ndaj nuk mbahet mend në ato vite asnjë hasmëri, asnjë vrasje apo sherr me përmasa të mëdha. Fjala e tij

mjalte qetësonte shpirtat e egërsuar. Njerëzia kishin besim të burri i urtë e i drejtë, askush nuk ia bënte fjalën dysh.

As atëherë kur njëri grabiti trarët e tjetrit dhe i vuri për tërë natën në çatinë e shtëpisë së tij. Ata e pikasën, morën armët dhe i vajtën në shtëpi.

Kur puna vajti majë më majë, arriti me ngut xha Xhaferi.

- Pa uluni të bisedojmë si burrat, - u tha, - kush ka parë hair nga sherri?

- Na ka vjedhur trarët natën, djersën e punës sonë, si mund ta falim?

- Faj i rëndë, - u tha, - po e ka një zgjidhje. Gjer nesër në mëngjes ky t'i presë trarët në Shelimuar, më të drejtë e më të gjatë se këta dhe me pendën e tij do t'i sjellë në shtëpinë tuaj. Si thoni?

- Po qe kështu në rregull, - thanë, - ne po ikim dhe po presim.

Xha Xhaferi e ndihmoi fajtorin të shpinte në vend trarët e vjedhur brenda afatit. Trarë më të drejtë e më të gjatë se të tyre, ndaj ata mbetën të kënaqur nga zgjidhja e mençur. Puna u bë urtë e butë, pa sherr e gjakderdhje.

Po të dëgjoje xha Xhaferin sherr nuk bëhej kurrë dhe njeri turpëruar nuk mbetej. Turpi ato mote ishte më i rëndë se vdekja dhe lahej me gjak. Grindje të tilla ndodhnin përherë dhe mund të përfundonin në gjakderdhje e hasmëri që zgjatnin me vite, po të mos u dilte përpara Xha Xhaferi me fjalën e urtë dhe autoritetin e madh në gjithë fshatin.

Vdekja i erdhi shpejt, pa mbushur tamam shtatëdhjetë vjeç. Erdhi ashtu pa pandehur, pa lajmëruar, ndaj njerëzia nuk e besuan. Si mund të vdiste kur i duhej fshatit si ujë e pakët? Nuk mund të vdiste, ja sa të çlodhej pakëz.

Dhe vërtet ai nuk vdiq. Ndonëse trupi prehet nën dherin e varrezave të fshatit, shpirti i tij vazhdon të sillet përreth, i prek me dorë të butë prej ajri njerëzit dhe ata bëhen më të mirë. Se burra si Xhaferi i Files së Dunicës nuk vdesin kurrë, po kujtohen jetë e mot ashtu siç po bëj edhe unë me këtë kujtesë të thjeshtë.

LASGUSHI DHE NDRË MJEDA POETË TË NDRYSHËM

Nga Sokol ZEKAJ

Lasgushi bëri një poezi të ngritur nga ana cilësore. Megjithatë, ritmika dhe fryma e poezisë së tij ishin më pranë poezisë popullore, asaj të jugut, madje në më shumë se një rast, ai beri inkursione poetike të vërteta drejt kësaj fushe. Këtë gjë, në mënyrën e vet e pati bërë edhe Fishta në Veri. Mjedes asnjëherë nuk i shkoi mëndja për "lëshime" të tilla. Formimi dhe vetëdija e tij estetike ishin solide dhe gati hermetike ndaj tyre. Nga ana tjetër, Lasgushi nuk krijoi dashakëqinj në jetë, ndërsa pati mbështetjen e vyer të Çabejt, të Kutelit e të Asdrenit. Kurse Mjeda, ndoshta edhe për sqimën artistike dhe intelektuale, më shumë ndjeu heshtjen rreth vetes, dhe njerëz që e shihnin shtrëmbër. Ndoshta në vitet e fundit, qe edhe i lodhur nga jeta. Koliqi na e paraqet "si një prift katundi ndërma të lanunit... verë e dimër mbërthyer në një pallto të rëndë të zezë".

Po mund të thuhet edhe kjo veshja e klerikut, nuk rri mirë në staturë të tij të poetit. Kjo gjë s'ka

pse të thuhet për Fishtën. Lasgushi nga nan tjetër, merrej si ishte, civil dhe modern, dhe kjo e ndihmonte. E njëjta gjë më vonë në popullaritetin e Migjenit, me histori dashurije, me albume të fotografive, me plot kujtime shokësh e miqsh, e me përjetime e përkujdesje fisnike familjarësh. Ndërsa autori i juveniljas nuk pati këtë fat. Ai mundi të jetë parë më dyshim, edhe nga besimtarët e tjerë edhe jo besimtarët. Të parët e gjykojnë, të dytët e paragjykojnë

Mjeda nuk shquhet për fuqi përshtetëse, Fishta po, po ashtu edhe Lasgushi. Për këta të dy kjo është një nga pikat e fortat të artit të tyre. Pranfëdaj Lasgushi është më pranë Fishtës se sa Mjedes si poet. Në bisedë të lirë thotë Koliqi, Mjedes nuk i rridhte fjala. Mjeda bën dekor, vendos planet ku do të zhvillohet drama e jetës, dhe më pas punon me pak detaje, të imta dhe të zgjedhura. Atij nuk i intereson tërësia e një shfaqje, por pjesë të saj, të cilat i bashkon sipas synimit të efektit potik ja si këto vargje. E nalt'qiell ma e bukur hana/Rreze të paqta shkon tue shkri/ Maje bjeshkeve fillon zana/ Nvalle shoqeve me u pri. Ai synon të na krijojë një gjendje po aq subjektive.



TË FALËSH ËSHTË NDER DHE TRIMËRI

Në të gjithë krijimtarinë e tij si në librin me tregime "Skaje" ashtu dhe në romanet "Përtej dashurisë", "Ndodh edhekështu", "Dashuri në mister", shkrimtari Myzafer Berberi trajton ngjarje të kohëve të ndryshme të së shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes, të shtrira në hapësira të gjera, brenda dhe jashtë vendit, në Shqipëri, Gjermani, Kinë, Kanada, Rusi, Xhamajkë, Kongo, Francë etj. Dhe, në të gjitha ai përcjell te lexuesi humanizmin, dashurinë për njeriun dhe më shumë se dashuri sakrificën për të, ëndërrimet e tij për një jetë më me shumë ngjyra, shpresën për një të ardhme të bukur, të sigurt; autori flet për dëlirësinë e shpirtit njerëzor që përipiqet të dalë përtej rutinës së përditshme e të mërzitshme, që kërkon të dalë nga shoqëria e vjetruar, e mykur dhe të ndërtojë një botë ndryshe nga e para. Me romanin "Kulla e nëmur" Myzafer Berberi e pasuron krijimtarinë e vet dhe letërsinë tonë me një vepër të re serioze, me një arkitekturë origjinale që, në këtë vështrim, ndryshon nga veprat e tjera të veta.

Autori ngre një problem të rëndësishëm që e shqetëson shoqërinë tonë, veçanërisht kur ky nuk është kapërcyer, nëse nuk është zgjidhur ose më mirë nuk është zhdukur, përsëri mund t'i kthehesh nga kënde të tjera shikimi dhe duke zbuluar edhe anë të reja të jetës apo të trajtimit më të thelluar përmes shikimesh të reja shoqërore-morale duke ndriçuar aspekte të reja të problemit dhe gjetje origjinale; struktura ku vendosen ngjarjet shtyjnë drejt një kuptimi dhe domethënieje të re.

Cili është problemi i kësaj vepre ?

Shkrimtari e ka marrë frymëzimin nga një ngjarje që është kthyer tashmë në plagë të shoqërisë shqiptare dhe që vazhdon edhe në ditët tona, siç është problemi i gjakmarrjes, hasmërisë.


Një kullë e nëmur dhe njerëzit e ngjuar brenda saj !

Në shekullin e XXI kur ne duam të integrohemi në familjen e madhe evropiane, gjakmarrja, ngujimi, vrasja për tokën dhe për të ruajtur nderin janë një plagë e madhe dhe përbëjnë një problem serioz për shoqërinë shqiptare. Edhe pse në roman ngjarjet, personazhet nuk zhvillohen në ditët e sotme, por në vitet e largëta, ideja e faljes së gjakut, e pajtimit midis familjeve përshkon romanin nga fillimi deri në fund.

Të falësh është nder, trimëri, - shprehet një nga personazhet e romanit. Trajtimi i gjakmarrjes nuk bëhet nga autori me ftohtësi, por me ndjenjë e dhembshuri duke u nisur nga dashuria për këta njerëz, nga dëshira për t'u thënë brezave të sotëm e të ardhshëm se duhet këputur zinxhiri i gjakderdhjes.

Problemi i zhdokjes, kapërcimit të hasmërisë, i fejesave që në djep, i lirisë së vajzës apo djalit për të zgjedhur vetë njeriun e zemrës kanë tërhequr me kohë vëmendjen e disa shkrimtarëve tanë dhe të Kosovës si R.Kelmendi me "Heshhtjen e armëve" (në kuptimin e gjaqeve), N.Rahmani me "Tymi i votrës së fikun". Është e njohur novela e I.Kadaresë "Prilli i thyer", romani i F.Açkës "Kryqi i harresës" dhe së fundi tani

Mendime për romanin "Kulla e Nëmur" të Myzafer Berberit



M.Berberi vjen me romanin "Kulla e nëmur", që në letërsinë e sotme edhe njëherë trajton gjakmarrjen, hasmëritë e vjetra e të reja, dilemën e emigrimit si shpëtim nga këto, tmerrin e fëmijëve të ngjuar, gra, burra, familje të tëra të mbërthyer nga "gracka" e Kanunit të Lekë Dukagjinit.

"Kulla e nëmur" është një vepër që kur nis ta lexosh, që në fillim të mbërthen dhe s'e lë dot. Kur hyn në të njihesh me personazhet dhe fatet e tyre, e sheh veten në shumëllojshmërinë e saj, futesh në bukurinë e peizazhit të përshkruar me mjeshtëri, vetëm atëherë kupton më mirë vlerat e romanit dhe thellohesh në domethënie të tij.

Myzafer Berberi ka aftësi të madhe përshkruese narrative me një plastikë të veçantë në gdhendjen e personazheve, të cilët kanë anët e tyre të shumta, të larmishme dhe nuk janë skematike. Gjatë leximit të romanit filli i mendimit nuk ndërpritet nga moria e personazheve kryesorë dhe të dytë, nga nëntituj të shumtë që, ndoshta megjithatë mund të mos viheshin të gjitha. Pra, një fill i padukshëm, i hollë lidh personazhet, ngjarjet deri në fund, sepse romani ka njëthurje të qartë.

Përmes personazheve të shumtë, ngjarjeve autori shpalos vlerat e mira të shqiptarit, besën, fisnikërinë, bujarinë, trimërinë, mikpritjen, por ja që këto virtyte të larta cyten nga një e keqe e madhe e ardhur nga kohë të lashta në dokun zakonor të gjakmarrjes. Rishfaqja e këtij akti tronditës në ditët e sotme është arsyeja që ka nxitur shkrimtarin Myzafer Berberi ta kthejë kokën në të kalu-

arën historike të realitetit shqiptar, ku forca e zakonit vepron në mënyrë çnjerëzore dhe jashhtë kohës së qenies së shoqërisë - të vepruarit e kanunit të Lekë Dukagjinit, kufijtë e të cilit arrinin deri në embriogjenezën mashkullore.

Personazhet e shumtë, secili me karakter të veçantë, që veprojnë në roman, autori i ka skalitur, veçanërisht kryesorët, prandaj edhe mbahen mend dhe lenë gjurmë te lexuesi. Të tilla janë Age Gjergji e djali i saj Ukë Toma, asketi "Gjorgu i mirë" i dashuruar me Leandrën, dashuri kjo që jetoi vetëm pak çaste, por që u ruajt në zemrën e tij për shumë vite përmes dhimbjes e vuajtjes, lutjes e sakrificash. Kjo figurë është realizuar nga autori mjeshtërisht. Por historia e dashurisë së tij me Leandrën nuk lidhet sa duhet me problemin kryesor të romanit, madje asketi është i shkëputur nga njerëzit. Me sa duket, autori nuk ka dashur të ngacmojë apo të ndryshojë traditën e hershme fetare të jetës së veçantë të asketit. Ai kupton se përtej shpresës që e mbajti gjithë jetën ekziston edhe një forcë që do t'i japë jetës një kuptim të skajshëm dhe krejt ndryshe nga ajo e zakonshme, me motivin që të përkushtohesh dhe të sakrifiko- sh për të tjerët, atëherë kur ti jeton pa shpresë dhe jeta e të tjerëve bëhet pjesë e jetës tënde. Ky është një meditim filozofik idealist i Myzafer Berberit që i jep jetës hapësirë të tejskajshme. Në fund të fundit "As vdekja dhe as varri nuk i tretin dot virtytet" - shkruan autori.

Të mbetet në mendje Sutë Shkurta, një malësore e besës, e fjalës, e veprimit të mençur. E vetmja grua në atë krahinë që pra-

nohej në kuvend burrash e, kur fliste ajo nuk kishte burrë t'ia kthente fjalën. Mbas humbjes së burrit të saj Dedë Tushës, të përpirë nga një ortek bashkë me vëllain e tij Luk Tushën, Sutë Shkurta me vajzën e saj pesë vjeçe, Filen, mbeti vetëm në kullën e Tushajve, një fis tjetër në fshatin Shumëgurra.

Në roman ngjarjet arrijnë kulmin, konfliktet midis personazheve vinë duke u rritur dhe mallkimi i kullës bie edhe mbi fshatin Gjinaj, duke ua prishur qetësinë banorëve, harmoninë shpirtërore vëllezërve Risto e Spiro Mitaj, njollos nderin e nuseve të tyre, Dalinës dhe Leonorës. Në roman nuk mungojnë episodet tërheqëse erotike, ku autori ve përballë virtyteve të larta të njeriut si, bukurinë shpirtërore, fisnikërinë, veset e shëmtuara të ulëta duke i dhënë ndëshkimin e merituar. Kështu, Leonora, një grua e re me pamjen e një djalushjeje, me shpirt të zi si të djallit, vret krijesën e vet Stavrin, i cili edhe pse kishte pamje "përbindëshi", shpirti i tij ishte i pastër, i bardhë. Për mëkatën që ajo bënte me Ukë Tomën, i cili vinte nga fisi i nëmur i Marashajve, trashëgimtari i fundit i tyre, ajo pësoi ndëshkimin e rëndë.

Fatal ishte dhe fundi i Dalinës, po ashtu e ndëshkuar për gabimin që bëri me Ukë Tomën. Atëherë, kjo e keqe e zezë që i vret trashëgimtarët qysh në embrion, që i vdes nuset gjatë lindjes, nga vjen? Mos është Ukë Toma apo i gjithë fisi i Marashajve me këtë gjak të shprishur? Autori mendon se ky çrregullim vjen nga jashhtë që është shkaktuar nga një lidhje martesore e largët me një femër helene. Kjo pikëpamje e autorit është e diskutueshme. Megjithatë, lexuesit nuk i del nga mendja Dalina, kjo nuse e re, të cilën Meropi, vjehrra e saj, e kishte dashur shumë si vajzën e saj ngaqë dhe ndryshonte nga Leonora, nusia e djalit tjetër, Ristos. Në vështrimin e sotëm, sjellja jo e moralshme e saj mund të mos merrte një ndëshkim të pakthyeshtëm. Kjo është një zgjidhje e drejtë nga ana e autorit duke gjykuar sipas asaj kohe, kur nderi e dashuria ishin të brishta.

Çdo lidhje dashurore me Ukë Tomën ishte e destinuar të mbaronte ose me vdekjen e grave gjatë lindjes ose me trashëgimtarë të përçudnuar, sepse mallkimit të futur në gjakun e Ukë Tomës nuk do t'i shpëtonte asnjë gjini femërore, ai do të dilte kudo.

Një meritë e veçantë e autorit është njohja e mjedisëve që trajton, gërshetimi i problemeve të cilat kanë për bazë një realitet të kaluar me tipa të veçantë, me gjuhë të natyrshme e shprehëse. Hera-herës ai kalon në rrëfime që në pamjen e parë duken të thjeshta e të njohura, të holla, po që gjithmonë janë tërheqëse, mbresëlënëse artistike. Krijimtarja e tij është shumë domethënëse; ajo është e mbushur me fjalë e shprehje të bukura, me një gjuhë të thjeshtë për t'u kapur duke bërë që lexuesi të tërhiqet vetvetiu në kuptimin e plotë dhe rrjedhshëm të përshkrimit. Këtu

bëhet fjalë për një anë tjetër të mjeshtërisë së autorit, ajo e pranisë së shkrimtarit në vepër, i cili duhet të jetë dominues, por i padukshëm. Ndërhyrja e autorit nuk është moralizuese, skematike, por duke e bërë veprimin të flasë, ai hyn midis kapitujve me forma të drejtpërdrejta përshkruese.

Lexuesit nuk mund të mos i bjerë menjëherë në sy se në roman, mund të them, për herë të parë në letërsinë e sotme gjejmë të gërshetuar dialektin verior dhe atë të jugut. Rrëfimi i ngjarjeve, dialogjet herë në gojën e personazheve të Shumëgurrasit dhe herë në dialektin e jugut, në gojën e atyre të fshatit Gjinaj, i japin një kolorit të rrallë duke e veçuar këtë roman të Myzafer Berberit nga krijimtaria e mëparshme e tij si dhe nga letërsia jonë e viteve të fundit. Por jo vetëm kaq! Kjo tregon se njerëzit lidhen, kuptohen edhe pse mund të flasin secili në dialektin e tij, sepse ajo është gjuha e të parëve tanë që kanë një histori, një traditë, një flamur.

Shkrimtari i është dashur të punojë një kohë të gjatë për fshatin e dialektit të veriut, ndërkohë, kur e ka pasur më të lehtë fshatin e dialektit të jugut, meqë është më afër gjuhës letrare me të cilën ai lidh ngjarjet, personazhet duke na zbuluar veçanërisht një gjuhë të zgjedhur, frazë të rrjedhshme, të lehtë gjatë përshkrimit të fshatit Shumëgurra, Gjinaj, kullës së Marashajve, "Ditës së Verës", veshjeve të malësorëve, netëve me hënë, të gjithë natyrës dhe fenomeneve të saj.

Romani zhvillohet në dy linja të gërshetuara me njëra - tjetrën, por që mund të qëndronin edhe veçmas. Nga njëra anë kulla ka vulën e mallkimit sepse të gjitha nuset e Marashajve vdesin gjatë lindjes duke marrë me vete fëmijën dhe të fshehtën tronditëse të kësaj fatkeqësie. Ndërsa kullat e tjera kishin pasur fatin e shumimit dhe të trashëgimisë së fisit, ajo e Marashajve kishte ardhur duke u shuar. Fisi i Marashajve nuk mund të kishte pasardhës.

Linja tjetër dhe më kryesorja në roman është ajo e gjakmarrjes. E drejta që i jepte kanuni atij që i ishte cenuar nderi, prona, toka, familja, i lejonte të merrte hak për ta vënë në vend nderin e fisit, të gruas, familjes etj. Kjo ishte arsyeja që një ditë ndaj të gdhirë nënë e bir, braktisën "Kullën e nëmur", lanë shtëpi e katandi dhe morën rrugën e gjatë drejt një të panjohure.

Karvani me Age Gjergjin, grua rreth të pesëdhjetave, djalin e saj Ukë Tomën, dy mushkat e ngarkuara dhe qenin, nisin rrugëtimin për të shpëtuar nga hija e pushkës së hasmit që nuk i ishte ndarë për asnjë çast.

"Kullës i duhej një pasardhës që të përcillej në breza jo vetëm emri dhe nderi i saj, por edhe armët e të parëve në duar burrash".

Pasardhësi i fundit i Marashajve, shpresa e vetme që do t'i jepte jetë, dritë kullës, do ta gjallëronte me zërat dhe të qeshurës e fëmijëve, që do të shpërdante hijen e zezë të mallkimit mbi të, mbeti si një legjendë për brezat e mëvonshëm.

Dr.Shk.Filologjike
Myzejen SHAPLLO

ARTI DHE ARTISTËT POPULLORË

Dhimitër Burnazi (Xha Miti), njeriu, që bënte gurin “të flasë”

Nga Dhimitër Gegprifti

Jemi në një vit jubilar. I ndryshëm nga të tjerë: në kohë për sisteme krejt të ndryshëm, por me një shtrirje shekullore, në një mbarim shekulli të njëzetë, në dekadën e dytë të shekullit XXI. Shqipëria dhe shqiptarët në 100 vjet Pavarësi dhe Shtet Shqiptar, në një shekulli të ri me një shtet modern bashkëkohor.

Në këta njëqind vjet janë të mishëruara dhe të konkretizuara ëndrra dhe përpjekje, dëshira dhe sakrificat, vlera dhe kontribute të këtij populli në historinë e tij mijra vjetore në të gjitha fushat e jetës, në mënyra kolektive, por edhe individuale. Nuk do të bënim gabim, as do të dukej e tepërt, nëse përdorim termin “plejadë” për të radhitur vlera të këtyre fushave në këta njëqind vjet, por duke shkuar më thellë në histori. Duke vazhduar traditën kulturore të fshatit Podkozhan të Mokrës Sipër (Pogradec), është hedhur ideja se nga qëndrimet më aktive të figurave shqiptare në trung të patriarkanës, ka qenë Arzen Vako nga familja e Zografëve të Korçës me origjinë nga Vakot e Podkozhanit. Këta piktorë kanë pikturuar agjeografe në mure kishash dhe ikona në Korçë, Voskopojë, Vithkuq, Myzeqe dhe në malin Athos në Greqi. Nikolla N. Naço, “njëri nga ideatorët dhe personalitetet më të shquara të shqiptarizmit...”, mërgimtarë dhe pjesëtarë në shoqëritë atdhetare “Drita” të Bukureshtit, “Dëshira” të Sofjes dhe “Vatra” të Amerikës. respektivisht: Stefo Thanasi, Kozma Vako, Vasil Silo, Simon Hila, Todi Risto Vako.

Një nga vlerat e banorëve të këtij fshati është gdhëndja e gurit, punimi me të, pothuajse në të gjitha nevojat e jetës së përditëshme: ndërtimi i shtëpive me qoshe guri të gdhëndura, qemere dyresh dhe dritarësh, varreza, lapidarë, gurë mulliri, mokra, kalldrëme, oxhakë të dekoruar, tavane, deri në skalitje busti si ai i Stalinit më 15 maj 1952 dhe të tjera vlera. Me këtë mjeshtëri ata siguronin jetën, derdhnin djersën dhe njëkohësisht ata në gurë linin një pjesë të historisë, të artit popullor dhe të traditës.

Të gjitha këto nuk mund të kuptohen pa kujtuar një emër, dhe të tjerë bashkëkohës me të ose pas tij: Dhimitër Janaq Burnaziv (Xha Miti), si është thirrur dhe njohur në pjesën më të madhe të jetës.

Pasaport post mortum

Dhimitër Janaq Burnazi u lind në fshatin Podkozhan të re-



thit të Pogradecit, Mokra Sipër në vitin 1887 në një familje me tradita patriotike. U nda nga jeta më 5 maj 1977, po në fshatin e lindjes. Nga moshë 13-vjeçare ai mbetet pa nënë dhe gjithë kohën e kaloi me babanë në mërgim në Rumani. Krijon familje me një vajzë, Arso, nga fshati Pleshisht dhe kjo nga një familje me tradita, me të cilën solli në jetë tre fëmijë: Todi, Marinën dhe Vangjelin.

Në fshat kryen tre klasë shkollë në gjuhën greke në vitet 1896-1899, pasi kjo shkollë ishte hapur nga viti 1811. Në moshën 19-vjeçare ai merr rrugën e kurbetit përfundimisht. Atje mëson profesionin e muraorit dhe të gurëgdhëndësit në guroren e Dobrukses. Një vit para Pavarësisë më 1911 ai kthehet në Shqipëri, por pas një viti, me kërkesë të pronarëve të gurores, në vitin 1912 ai shkon

tesë Xha Miti... Por përnjëherësh mendja të shkon tek mjeshtri dhe artisti popullor i gdhëndjes së gurit. Tek ai, që me aq durim e këmbëngulje, një cope guri të këputur nga shkëmbejt e Mokrës, dhe jo çdo gur, kërkon te t'i jepte një formë të caktuar, një dekor, një simbol për ta joshur shumë sy, për ta kthyer atë në një vepër arti, që të sjell kënaqësi estetike.

Ai ishte një burrë me trup mesatar, me një veshje karakteristike, preferonte ngjyrat e çelura midis së bardhës dhe të verdhës dhe në kohë dimri dhe një pallto të trashë treçerëshe, por asnjëherë pa kapele dhe pa çibukun e duhanit, të cilin do ta kishte në buzë ose në dorë. Me ato qepalla e mustaqe, flokë e sy bojëqielli në të bardhë. Me një buzëqeshje karakteristike me çibukun, që digjej. Ai fliste pak, por dëgjonte shumë.

Atë ose do ta gjeje duke punuar me gurin ose do të të fliste për gurët, mjeshtërinë. Ai nuk punonte çdo lloj guri. E dinte dhe e zgjidhte ai. Atë do ta shihje me veglat e punës në dorë. Në shtëpinë e tij edhe sot është e pranishme dora e këtij artisti në gdhëndje të ndryshme apo foto. Nëse shkon diku apo sheh diçka të gdhëndur në gur, pa tjetër do të sjellësh ndër mend një emër artistin e daltës së gurit xha Mitin e Burnazit nga Podkozhani.

Një jetë e tërë lidhur me fshatin, gurin dhe artin

Ky artist i daltës jetoi jo pak, por nëntë dekada, nga të cilat dy në mërgim dhe gjashtë në atdhe. Për asnjë cast nuk e hoqi atë

nga dora. Jeta dhe aktiviteti i tij nuk lidhet vetëm me mjeshtërinë e gdhëndjes, por dhe me kontribute në jetën e fshatit. Nga viti 1942 e në vazhdim mori pjesë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, ku zgjidhet anëtar i K.N.ÇL. të fshatit. Dhjetor 1943 deri nëntor 1944 zgjidhet kryetar i K.A.N.ÇL. të fshatit. Shijet e holla të artit të tij nuk i njeh dhe shijon vetëm Mokra, por Gora e Devolli, Korça e Pogradeci, Tirana e Durrësi. “Kjo punë, thoshte ai, kërkon shumë kujdes dhe durim të madh!”. Kontributi i tij pas Çlirimit është i fiksuar në lapidarët e dëshmorëve të Atdheut, si të patriotit Dhimitër Misha, në vitin 1949 punon për ngritjen e lapidarit të Dëshmorëve të Pojskës. Në Tiranë dhe Durrës, të gjitha qoshet e Bankës së Shqipërisë. Në ornamente popullore ai gdhëndi shqiponjën, simbolin e kombit, elemente floreale. Me kërkesën e autoriteteve të kohës ai skaliti me mjeshtëri të rrallë artistike bustin e Stalinit. Me inisiativën direkte të zotit Moikom Zeqo, një pjesë të punimeve artistike të këtij artisti u vendosën në Ekspozitën e Kulturës Popullore Shqiptare në rubrikën “Arti Popullor”-Punime guri e hapur në Tiranë në vitin 1980.

Ndërsa zoti Tomi Mato, regjisor, kujton se këto punime kanë shkuar dhe në Ekspozitën Etnografike në Shkodër. Me këto punime është botuar dhe një kartolinë me autorin e tyre, xha Mitin me daltën, çekani, skuadrin, pa dyshim dhe çibukun.

Ky është Dhimitër Janaq Burnazi, artisti i gdhëndjes në gur me motive nga më të ndryshmet e jetës.

përsëri në Rumani dhe punon si gurëskalitës në disa qendra, qytete, objekte të ndryshme., si: Kostancë, Bukuresht, Dobrukhe. Më shumë nëpër kisha. Në një nga kishat e Kostancës ai ka skalitur dhe emrin e tij. Në vitin 1916 kthehet në atdhe i mobilizuar nga ushtria austriake që në Rumani, si ushtar me kombësi shqiptare. Periudha 1916-1917 kryen detyrimin ushtarak në qytetin e Shkodrës, duke u kthyer përsëri në fshatin e lindjes.

Meditim...

Xha Miti... Podkozhani, mbase dhe fshatra të tjerë, ka të veçantë përsëritjen e të njëjtit emër nga shumë të tjerë, por dallohen nga fisi dhe atsia, pse jo dhe nga profesioni, mjeshtëria. Kështu na ndodh edhe, kur sjellim ndër mend emrin me ndajsh-



TALENTET E FISIT GUSHO

Nga Sulejman MATO

Talenti është i përsëritshëm edhe brenda një geni. Ka shumë shkrimtarë botërorë, ndër ta edhe shqiptarë, të cilët janë edhe trashëgimtarë edhe të një stërgjyshi i cili, gjatë jetës vet, ka shfaqur talent letrar. Koha mund të ketë përcaktuar një bejtexhi fshati ose një poet, të dështuar për kohën, por brezat e më vonshëm kanë vashduar traditën e tij letërore. Në trungun poetik Gusho, shkëlqeu poeti i njohur Lazër Gusho (Lasgush Poradeci) por, nga ky fis, para tij dhe më vonë, kanë dalë dhe po dalin talente letrare, si: shkrimtari i njohur Dhimitër Xhuvani, shkrimtarja Elena Gusho, (Kadare) dhe dramaturgu Mirosh Marko e tjerë.

Krijimi është një gjendje e veçantë ku, siç thotë I. Kadare, "truri i shkrimtarit pulson si në ethe", ndonse në çdo çast ai gjendet në vetëkontroll. Poeti gjerman Emil Verharen, e përcakton krijimin në këtë mënyrë: "Të shkruash do të thotë të ndiesh me mendje dhe të mendosh me zemër", që do të thotë ndjenja të ruaj masën e kontroluar nga mendimi dhe mendimi të ruaj masën e vet, të kontroluar nga ndjenja. Kjo është një maksimum shumë e saktë për të treguar harmoninë që duhet të ketë raporti ndjenjë-krijim, si dhe vetë kontrolli që duhet të bëhet krijimit nga të dyja këto qendra krijuese. Në çdo krijim, parësore duhet të jetë ndjenja.

Edhe mendimi duhet të jetë parësor, por gjer në masën e duhur.


Mësuesi i letërsisë, në një farë mënyre, duhet të jetë vetë letrar ose të njohë mirë metodën krijuese, në mënyrë që të bëjë edhe një punë të diferencuar me nxënësit. Ai nuk duhet ti imponohet nxënëseve me mendimet e veta, por tu japë atyre parimet e përghithshme të krimit dhe disa sqarime të pjesëshme rreth temës që do të trajtojë.. Detyra e tij është ta joshë nxënësin e më pas ta nxitë atë për të medituar rreth temës. Mësuesi duhet të jetë në rolin e mediumit për ta çuar nxënësin gjer në atë pikë ku "truri të pulson si në ethe", i gatshëm për të nisur skicën letrare. Gjithmonë me parimin që nxënësi është i lirë dhe ka hapësirë të plotë për të dhënë një krijim sa më real, sa më të besueshëm dhe sa më origjinal...

Ese-ja "kolektivçe" është një lloji gare midis nxënësve. Krijimi i juaj, sa më origjinal, bëhet edhe më joshës, po të mendosh që eseja më e mirë do të lexohet në klasë, para të gjithëve, dhe do të vlerësohet me një notë, e cila ka rëndësinë e saj. Në orën e esesë, nxënësi duhet ta ndiej vetnë jo si në klasë, por si një qafë mali, ku zemra nis të trokasë më ndryshe edhe truri, i cili gjendet si në ethe, nis të vegojë gjithçka që sheh me "syrin e zogut" syrin e imagjinatës.

ZBULOHEN NË PRESPË PIKTURA TË NEOLITIT

Nga Petrika LERA

Zbulohen në zonën e Prespës 27 piktura murale, që datojnë rreth 7 mijë vjet, para erës së re, pra në periudhën e neolitit të herëshëm dhe vërtetojnë se kjo zonë ka qënë e banuar prehistorikisht. Vizatimet mijravjeçare janë zbuluar në shpellën e Maricës, në bregshkëmbin e Prespës, nga një grup arkeologësh shqiptaro-grekë, që për të katërtin vit kanë ndërmarrë ekspeditë arkeologjike me qëllim zbulimin e vendbanimeve të herëshme apo gjurmime që mund të gjenden nga njerëzit prehistorikë. Si rezultat i formacione kalkare janë krijuar guva dhe streha shkëm-



bore, ku njëra prej tyre paraqet mjaft interes, sepse në të janë vizatuar mjaft figura me bojë të kuqe. Figurat paraqesin skema njerëzore të skematizuar kryqi, paraqesin kafshë të ndryshme apo kryqe të brendashkruar.

(Vijon nga faqja 7)

Në Valamarë midis tre qytetave asaj të Llëngës, Niçës e Osnat në Valamarë. Ndodhet një vënd burim ujqor që i thonë "Cezma e Nuseve" atje ka qënë një Bredh i madh dhe një Kumbull, të gjithë dasmorët e Nusia ndalen këtu për të marë Uratën e Bekimin e Zotit

Kënga thotë: Nusja i thotë Vëllamit: Tek çezma e Kumbulla, ndal kalin të zbrës, Të mar bekimin e Uratën. Nga dasmoret këndohej: Sa lule ka kumbulla, aq fëmijë të lindë Nusia, burimi ujqor është vetë rrjedha e jetës * Lla fëntëna, Sënë kallu, S'ëmëdë punë atje Arvanitase Çobani!

Çobani e ndezi zjarin, Për të kthyer krabën, Kraba ju thye nga zjari, Cobani qan me lot, Lllaj çoban-ka i thotë çobanit, Hajde të të puth njëçikë, Se kam pirë një gotë verë, Ujku le ti hajë dhite!

*Pagëzimi i të lindurve dhe

Eno Milkani: "Të njohim Ballkanin përmes filmit dhe kulinarisë"

Janë disa festivale filmash në Shqipëri që pak nga pak ndërkombëtarizohen edhe pas edicioni me ambicien për të hyrë në rrjetin e festivaleve të rëndësishme ndërkombëtare që zhvillohen kudo në botë. Por përtej kësaj, krijuesve, regjisorëve, kritikëve dhe publikut shqiptar përmes këtyre festivaleve u jepet mundësia të njihen me prodhimet më të fundit të kinemasë botërore.

Tek-tuk në to gjen një qoshe edhe kinemaja ballkanike ose më saktë ajo pjesë e kinematografisë ballkanase që arrin me sukses të dalë jashtë kufijve të saj. Në Pogradec zhvillohet i vetmi Festivali Ballkanik i Filmit dhe Kulinarisë (Balkan Film Food Festi-

val), ideuar nga organizatorët Eno Milkani, Fatos Baxhaku dhe Gerta Qurku, si takim i filmit dhe kulinarisë ballkanase.

Nesër nis edicioni i dytë i këtij festivali, që përveç shfaqjes së 50 filmave publiku do të ketë mundësinë të shijojë edhe gatimet tradicionale të vendeve pjesëmarrëse. "Mendoj se kjo është mënyra më e mirë që ne të njohim njëri-tjetrin", - thotë me bindje regjisorin Eno Milkani.

Në zyrën e tij diku pranë Bllokut ai po merret me përgatitjet e fundit. Sapo ka përfunduar posterin, programin e filmave që do të shfaqen dhe po freskon faqen online të festivalit me logot e sponsorëve, ku mes tyre është dhe Universiteti Europian i Ti-

ranës. Dy bashkëpunëtorët e tjerë gazetari, Fatos Baxhaku dhe Gerta Qurku ndodhen në Pogradec, duke i dhënë dorën e fundit detajeve teknike të festivalit. "Të marrësh iniciativën për të organizuar një festival filmi nuk është e lehtë.

Megjithatë, ne jemi të bindur në vazhdimësinë e kësaj tradite", - thotë i riu Milkani. Nga përvoja e edicionit të kaluar, Eno Milkani i është qartësuar bindja se ballkanasit e njohin shumë pak njëri-tjetrin. Sipas tij, njohja që ne kemi për fqinjët tanë është ajo që na ofrojnë kronikat e lajmeve, ndërkohë që filmat që shfaqen në Festivalin Ballkanik të filmit na japin një panoramë krejt tjetër.

NDRE MJEDA I DERGON LETRA NIKOLLA NAÇOS, NË BUKURESHT

Nga Ben ANDONI

Dorëshkrimet e letrave autografe të Mjedës, përcjellë albanologëve Gustav Meyer, Holger Pedersen, Zef Valentini, apo personaliteteve të tjera janë zbuluar në arkivin e bibliotekës së Grazit. Depatamenti i dorëshkrimeve të bibliotekës Mbretërore të Kopenhagenit, arkivi i Propogandës Fide, Romë, arkivi i Jezuitëve Romë, arkivi i Vatikanit, arkivi Shtetëror i Vienenës, arkivi i Jezuitëve Krakovit, arkivi i Muzeut historik Shkodër, arkivi Qendror Shqiptar, si dhe në arkivën personale. Vazhdojmë me historinë e zbulimit të gjashtë letrave të Mjedës dërguar Holger Presidentit, të cilat arritëm t'i futim në dorë para tre vitesh. Në të vërtetë kishim vite që parashikonim ekzistencën e tyre dhe punonim me ngulm për zbulimin e tyre. U desh të vinte shtatori i vitit 2008, që të bashkoheshin disa faktorë të rastësishëm, por që bënë të mundur identifi-



Dum Ndre Mjeda (1866 - 1937)

fikimin e tyre dhe kthimin e kopjeve të tyre në atdhe. Ishte një telenovelë me fund të lumtur, një shembull që tregon se ia vlen të guxohet, duke kërkuar në drejtime që më parë as smund t'i shkonte ndërment njeriut. Interesante por dome-thënëse është parashikimi dhe zbulimi i letrës në dorëshkrimin autograf të 3 janarit 1893 që Mjeda i dërgoi ril-

indasit Nikolla Naços në Bukuresht. Në botimin tonë të vitit 1988 duke ju referuar letrës në dorëshkrim të Mjedës dërguar Gustav Meyerit më 2 shkurt 1893, kishim parashikuar që Mjeda ka patur letërkëmbimin me kryetarin e shoqërisë "Drita" të Bukureshtit, Nikolla Naçon. Më vonë e përsëritëm parashikimin në vitin 2006: "Mjeda ka psur lidhje me kryetarin e shoqërisë Drita, Nikolla Naçon (1843-1913) në Bukuresht... (Naço mbajti lidhje me atdhetarë, në mes të cilëve edhe me fondin e shoqërisë Drita" Nuk kaloi një vit dhe pikërisht kjo letër në dorëshkrimin autograf që Ndre Mjeda i dërgoi Nikolla Naços, më 3 janar 1893 u bë pronë e arkivit tim. Ne e transkriptuam dhe e botuam me shënime sqaruuese në vitin 2007. Para dy dekadash, duke punuar në arkivin e Oborrit në Vjenë, mësuam për letra kofidenciale që i dërgonte Ndre Mjeda prefektit të Propaganda Fides, Kardinalit Miacilao Ledohovski nga viti 1901-1902, lidhur me konfliktin që kishte me Abatin Doçi.

"Kushtetuta e Arumunëve" e cila ka Moralën për bazë, prej principeve të saj udhëhiqet familja, . fisi dhe gjithë mardhënjet në komuniteti

* "Urdhëresat", janë porositë e dhëna nga Kumbari fëmijës në ceremoninë e Pagëzimit të predikuar në Kishë a shtëpi në prani të Uratës i cili në emër të Zotit, Bekon ardhjen në jetë të fëmijës Formula e Pagëzimit. "Unë të pagëztoj në Emrin e Atit të Birit e të Shpirtit të Shënjtë, Amin" dhe çertifikon emrin e fëmijës propozuar nga Kumbari. Më pas Kumbari i cili ka detyrime afat gjate për atë vajzë a djalë deri në moshë të rritur kur ai të lidhet në martesë, dhe në atë tavolinë Kumbari vendoset në krye të Këndit. në përgjithësi, kumbari e trasmeton këtë detyrë e përgjegjësi brezave, kur ai mplaket apo nuk është më në këtë jetë. Kumbari udhëzon e lut për atë fëmijë të Pagëzuar para Zotit, duke e udhëzuar qe këto parime e mirësi ta udhëheqin ate në jetë të jetës

1- Të rritesh me Nënë e me Babë e paç fat në jetë

2- Të rritesh i shëndetëshëm, Të jesh mbi shokët. Ti rrahësh, mos të të rrahin !.

3- Të bëhesh i mënçur, t'ja u hedhësh të tjerëve, Mos të ta hedhë njeri. . .

4- Ri me shokë të mirë, Në do të bëhesh njeri i mirë.

5- Të jesh i nderëshëm në jetë, Në çezmë "Belik" mos pish ujë. Po t'ju pyesë njeri për një vajzë, folë mirë mos e shaj, po t'ju pyesin për një djalë thuaj të vërtetën mos shpif

6- "Hari karti, hari Parti" Ke kartë ke të drejtë, Nuk ke Dokument nuk të jepet e drejta

7- Kur ble një pronë, pyetë e ka venë vetë, apo e ka të gjetur të trashëguar ?.

8- Malli i shtrenjtë të koston më lirë, Malli i liri të shkoni më shtrenjt

9- Njerinë se sa është i rregullt, vlerësoje nga gjëra që nuk kostojnë sikurëse është pastërtia, larja, rruarja, prerja e thonjëve, këpucët e bo-

jatisura apo mbajtia e rrobave të hekuurosura

10- Një gjë është sekret, në qoftë se dihet nga një njeri, në qoftë se ai dihet nga dy persona ka 50 % të vlerë, në qoftë se mësohet nga një femër, nuk quhet më i tillë.

11- Njeriu merret më qafë duke qënë Llafaza, Alkolist dhe duke ndenjur pas Udheqjes

12- Atë që se do ta mallkoje thuaj "Zoti të mërztitë punë" Te gjithë të këqiat vinë pas. Puna nuk është turp, . Turp është të vjedhësh të kurvërosh të luash kumar e të merësh me poshtërsi.

13- Lutju Zotin, mos të të hyjë vetja në Qejf

14- Mos Gënje kurrë! Mbasi ai që gënjën i ka, dhe i bën të gjitha të zezat

Fund

Shënimi:

*Belik: Mos shkosh me gratë e botës